



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2014



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR**

MESAZHI NGA INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Raporti i veprimtarisë së inspektimit për vitin 2014, të cilin po ju paraqesim, është një pasqyrë e veprimtarive të kryera nga i gjithë sistemi i inspektimit për arritjen e rezultateve të pritshme të reformës së inspektimit. Gjatë kësaj periudhe Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore kanë zhvilluar veprimtari intensive në drejtim të avancimit të sistemit “e-Inspektimi” si pjesë e rrjetit të qeverisjes elektronike. Sistemi “e-Inspektimi” pritet të krijojë hapësira për të rritur transparencën dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese, si dhe uljen e korrupsionit dhe përmirësimin e klimës të të bërit biznes në vendin tonë.

Nën udhëheqjen metodologjike të Inspektoratit Qendror, gjatë vitit 2014, Inspektoratet Shtetërore ndërmorrën veprimtaritë për standardizimin dhe përshtatjen e procedurës së tyre inspektuese me procesin e ri të inspektimit. Ato filluan të zbatojnë në praktikën e tyre të përditshme të inspektimit, procedurën, dokumentacionin dhe metodologjitë e reja të inspektimit. Inspektorati Qendror i udhëhoqi ato me ndryshime ligjore, metodologjike dhe i trajnoi inspektorët shtetërorë për aplikimin e procedurës së re të inspektimit, me qëllim që të arrihet një mbrojtje më e lartë e cilësisë së jetës dhe konsumatorëve.

Nën mbikëqyrjen e Inspektoratit Qendror, Inspektoratet Shtetërore përmirësuan efektivitetin e punës së tyre dhe rritën performancën duke sjellë forcimin e rolit të tyre në parandalimin e reziqeve dhe garantimin e zbatimit të rregullave të detyrueshme në veprimtarinë e subjekteve të inspektimit e konkurrencën e ndershme. Për pasojë u rrit forca ndëshkuese e tyre për rastet e mosrespektimit të rregullave të detyrueshme. Ndërkohë, disa Inspektorate Shtetërore janë ende në proces riorganizimi dhe po punojnë për realizimin e tij sipas legjislacionit në fuqi, për t'i shërbyer më mirë sigurisë publike dhe subjekteve të inspektimit.

Një arritje tjetër është edhe përmirësimi i frymës së bashkëpunimit ndërmjet Inspektorateve Shtetërore, që ishte edhe një nga risitë e reformës së inspektimit, për ta parë inspektimin, si një veprimtari shtetërore të unifikuar dhe jo të ndarë në fusha influence, por si një aktivitet ku ka vend edhe për inspektime të përbashkëta, bazuar në procedurë, dokumentim dhe teknologji të njëjta për të gjithë sistemin e inspektimit.

Ne duhet të punojmë së bashku për ta kthyer sistemin e ri të inspektimit në histori suksesi për Qeverinë Shqiptare dhe për të garantuar sigurinë publike dhe cilësinë e jetës në vendin tonë.

Ilir ZELA

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM

PËRMBAJTJA

MESAZHI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

- I. PËRMBLEDHJE**
- II. HYRJE**
 - Qëllimi
 - Objektivat
 - Metodologjia
- III. FINALIZIMI I REFORMËS NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT**
- VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT.**
 - 1) Ministria e Punëve të Brendshme
 - 2) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
 - 3) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
 - 4) Ministria e Arsimit dhe Sportit
 - 5) Ministria e Kulturës
 - 6) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
 - 7) Ministria e Shëndetësisë
 - 8) Ministria e Energjisë dhe Industrisë
 - 9) Ministria e Mjedisit
 - 10) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
- V. KOMENTE**
- VI. PRAKTIKAT E MIRA**
- VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR**
- VIII. REKOMANDIME**
- IX. KONKLUZIONE**
- X. ANEKSE**
 - ANEKSI I:** Lista e akteve nënligjore të miratuara gjatë vitit 2014 nga Inspektorati Qendror
 - ANEKSI II:** Ligje Sektoriale të miratuara gjatë vitit 2014.
 - ANEKSI III:** Draft aktet nënligjore për miratim.

I. PËRMBLEDHJE

Sistemi i inspektimeve i është nënshtruar një reforme, si rezultat i së cilës të gjithë komponentët përbërës të tij, ligjor, riorganizues, programues e metodologjik dhe procedural, kanë pësuar ndryshime thelbësore, të cilat sollën një rritje të performancës së këtij sistemi. Modeli i ri i inspektimeve që po zbatohet sipas parimeve të ligjit të inspektimit, ka vendosur standarde të unifikuara organizative dhe procedurale të inspektimit, dokumentacion dhe teknologji të njëjtë të aplikuara për të gjithë Inspektoratet Shtetërore. Procesi i inspektimeve është ndërtuar sipas drejtimeve të inspektimit elektronik, me rezultate të pritshme në rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Aktualisht, ka përfunduar procesi i riorganizimit për 5 Inspektorate Shtetërore dhe është në proces riorganizimi Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, si dhe Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut i cili do të bashkojë disa funksione inspektimit të ngjashme për nga natyra e tyre, por që aktualisht kryen të ndara nga njëri-tjetri.

Reforma e inspektimit bëri të mundur edhe fuqizimin me teknologji informacioni të Inspektorateve Shtetërore nëpërmjet përdorimit të portalit unik “e-Inspektimi”, i cili ka filluar të operojë dhe ka dhënë mundësinë që një pjesë e konsiderueshme e inspektimeve të kryhen nëpërmjet tij. Një pjesë e inspektorëve shtetërorë, të cilët kryejnë procedurën e inspektimit në mënyrë elektronike janë pajisur me paketa portabël inspektimi dhe të tjerë janë në procedurë për t’u pajisur me to, duke bërë të mundur inspektime dhe regjistrime të procedurës në kohë reale nga terreni. Këto paketa përdoren nga inspektorët në terren duke bërë që të rritet transparencja dhe efektiviteti i punës së tyre dhe që çdo inspektim të jetë i gjurmueshëm dhe rezultatet e konstatimeve të patjetërsueshme.

Gjatë vitit 2014 ka avancuar funksionimi i Portalit “e-Inspektimi” dhe duhet theksuar se inspektimet e kryera nëpërmjet këtij portali kanë shkurtuar afatet kohore të qëndrimit të inspektorëve shtetëror pranë subjektit të inspektimit, si dhe kanë kontribuar në minimizimin e veprimeve abuzive gjatë procesit të inspektimit. Në përmbushjen e objektivit për komunikimin e Portalit unik “e-Inspektimi” me sisteme të tjera dhe krijimin e regjistrimit elektronik të akteve inspektuese si pjesë e bashkësisë së regjistrave elektronikë në vend, Inspektorati Qendror ka nënshkruar dy Marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrën Kombëtare të Licensimit, për të shkëmbyer të dhënat me këto institucione, si dhe është duke u finalizuar Memorandumi i Bashkëpunimit midis Inspektoratit Qendror dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili synon komunikimin e sistemit “e-Inspektimi” me sistemin e dixhitalizuar të tatimeve për shkëmbimin e të dhënave.

Raporti i Përgjithshëm për veprimtarinë e inspektimit në Republikën e Shqipërisë për vitin 2014, përfshin gjetjet në veprimtarinë e Inspektoratit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore, praktikat e mira, konkluzione, si dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e performancës së tyre në të ardhmen. Ky raport paraqet arritjet e reformës së inspektimit të cilat gjatë kësaj periudhe u konsoliduan duke sjellë rezultate konkrete si: planifikimi i veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, unifikimin e procedurës së inspektimit, dokumente standarde të evidentimit të veprimtarisë inspektuese, cikël trajnimesh unike për rritje të performancës së inspektorëve shtetërorë, metodologji inspektimi të unifikuar, forcimin e mbikëqyrjes dhe koordinimit të veprimtarisë inspektuese nga ana e Inspektoratit Qendror, nëpërmjet ushtrimit të kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë

inspektuese në disa Inspektorate Shtetërore, si: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Inspektorati Qendror Teknik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Nëpërmjet këtij aktiviteti mbikëqyrje është vlerësuar veprimtaria e Inspektorateve shtetërore, me disa mangësi, si dhe janë raportuar këto problematika të hasura, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese me qëllim përmirësimin dhe unifikimin e veprimtarisë inspektuese në të gjithë sistemin e inspektimit. Gjithashtu u mundësua zbatimi me korrektësi i ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit nën koordinimin e Inspektoratit Qendror.

Vëmendje i është kushtuar rritjes së kapaciteteve për inspektorët shtetërorë nëpërmjet miratimit të Kodit të Etikës për inspektorët shtetërorë dhe trajnimit të tyre mbi legjislacionin, procedurat e reja të inspektimit, si dhe përdorimin e portalit “e-Inspektimi” nëpërmjet paketave portabël për ata inspektorë që i përdorin ato. Në kuadër të rritjes së efektivitetit të punës së tyre u krijua Regjistri Kombëtar i inspektorëve shtetërorë në detyrë i cili është publikuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror dhe në portalin “e-Inspektimi”. Inspektorët shtetëror janë pajisur edhe me kartë inspektori shtetëror me të cilën identifikohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre inspektuese.

Synimi ynë është që këto arritje të deritanishme të shtrihen në të gjithë Inspektoratet shtetërore në Republikën e Shqipërisë, për krijimin e një sistemi modern inspektimesh në linjë me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.

II. HYRJE

Ky Raport jep një përmbledhje të rezultateve të arritura pas implementimit të reformës së inspektimeve dhe të impaktit që ajo ka patur në sistemin e inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Raporti pas analizës së hollësishme të ndryshimeve të ndodhura në sistem do të udhëzojë finalizimin e reformës së sistemit të inspektimit në Shqipëri.

Qëllimi i Raportit

Raporti synon të japë një vlerësim objektiv për arritjet e procesit të inspektimeve në vendin tonë gjatë vitit 2014, një panoramë të plotë të aktivitetit të kryer nga Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për vitin 2014, analizë e veprimtarisë së Inspektorateve Shtetërore me gjetjet e konstatuara gjatë misionëve të mbikëqyrjes të Inspektoratit Qendror, si dhe rekomandimet e dhëna në raportet e mbikëqyrjes, me qëllim që të bëhen përmirësime në të ardhmen.

Raporti rrit transparencën ndaj subjekteve të inspektimit dhe publikut të gjerë, për arritjet e sistemit të inspektimit, aktivitetin e zhvilluar nga Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore dhe përmirësimin të performancës së tyre në të ardhmen.

Objektivat e Raportit

Hartimi i këtij raporti bëhet në përmbushje të detyrimeve ligjore që ka Inspektorati Qendror për aktivitetin e përvitshëm të:

1. Të evidentojë veprimtarinë e vitit 2014 për të gjitha inspektorateve shtetërore që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Të japë me transparencë dhe objektivitet gjetjet e konstatuara nga Inspektorati Qendror gjatë mbikëqyrjes së aktivitetit të Inspektorateve Shtetërore, si dhe rekomandimet për përmirësimin e aktivitetit të tyre.
2. Paraqitja e këtij raporti për njohje Këshillit të Ministrave, sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.
3. Të njoftojë Inspektoratet Shtetërore për nevojën për të bërë ndryshimet e duhura dhe në kohë për të rritur performancën në inspektime, si dhe ndërgjegjësimin e publikut.
4. Të vendosë rregulla dhe standarde të përgjithshme të raportimit të Inspektorateve Shtetërore sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur është ajo e raportimit në mënyrë të progresive të arritjeve në sistemin e inspektimit. Për këtë u bënë analiza dhe vlerësime të dokumenteve strategjike të inspektimit, legjislationit në fuqi për inspektimin, si dhe të gjetjeve në raportet e mbikëqyrjes së disa Inspektorateve Shtetërore të hartuara nga Inspektorati Qendror gjatë vitit 2014.

Gjithashtu, për hartimin e Raportit të Përgjithshëm vjetor të inspektimit për vitin 2014 u analizuan raportet vjetore të hartuara nga Inspektoratet Shtetërore për vitin 2014, për fushat e inspektimit që ato mbulojnë, duke bërë edhe vlerësimin e veprimtarisë së tyre.

Pas analizës së përgjithshme të sistemit, jepen edhe konkluzionet dhe rekomanimet për përmirësimin e punës, rritjen e efektivitetit dhe fuqizimin e Inspektorateve Shtetërore.

III. FINALIZIMI I REFORMËS NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT

Inspektorati Qendror, mbështetur në objektivat Strategjik për periudhën 2014-2017 dhe Planin e tij të Veprimt, ka zhvilluar aktivitetin për arritjen e objektivave, për të përmbushur misionin e vet të rritjes së efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Në vijim të reformës në sistemin e inspektimit dhe bazuar në konkluzionet e Raportit të Përgjithshëm të një viti më parë, Inspektorati Qendror ka rritur bashkëpunimin e tij me Inspektoratet Shtetërore, si dhe ka nxitur bashkëpunimin mes vetë inspektorateve shtetërore për të bërë të mundur bashkërendimin e aktivitetit të tyre inspektues.

Gjatë vitit 2014 Inspektorati Qendror ka zhvilluar aktivitete që kanë synuar rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore. Në këtë kuadër janë hartuar një sërë aktesh nënligjore, raporte mbikëqyrëje, rregullore, manuale të cilat synojnë unifikimin e procedurave dhe dokumentacionit të inspektimit për të gjitha fushat dhe funksionet e inspektimit në juridiksionin e ligjit të inspektimit.

- *Zbatimi i parimeve të ligjit për inspektimin*

Inspektorati Qendror me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe në konsultim me Inspektoratet Shtetërore, përgatiti Kodin e Etikës për punonjësit e Inspektorateve Shtetërore, i cili është miratuar me Urdhrin nr. 28, datë 17.04.2014 “Për miratimin e kodit të etikës për punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë” të Inspektorit të Përgjithshëm. Kodi i Etikës kishte si qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë, parandalimin e sjelljeve korruptive dhe konfliktin e interesit gjatë kryerjes së detyrave nga Inspektorët Shtetërore. Broshura u printua në 560 kopje dhe ju shpërnda inspektorëve të të gjitha inspektorateve shtetërore. Kodi i Etikës për punonjësit e Inspektorateve Shtetërore është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjithë punonjësit e Inspektoratit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore gjatë ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre zyrtare, duke rritur performancën dhe profesionalizmin e tyre në përputhje me përcaktimet e tij.

Për të rritur sigurinë në procesin e inspektimit u miratua karta e inspektorit shtetëror me Urdhrin nr. 32, datë 29.04.2014 “Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit”, të Inspektorit të Përgjithshëm. Në zbatim të këtij urdhri u pajisën më kartë të inspektorit shtetërorë 987 inspektorë të inspektorateve shtetërore dhe trupa inspektuese, të cilët sipas parimeve të ligjit për inspektimin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre inspektuese identifikohen me kartën e inspektorit, duke shmangur veprimet abuzive të personave të pa autorizuar për inspektim.

- *Unifikimi i metodologjisë, procedurës dhe dokumenteve të inspektimit*

Për të unifikuar dokumentet që përdoren gjatë procesit të inspektimit, në zbatim të ligjit për inspektimin, u hartuan dokumentet standarde të inspektimit të cilat u miratuan dhe hyn në fuqi me Urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Inspektorit të Përgjithshëm. Në zbatim të këtij Urdhri, Inspektoratet Shtetërore përshtën dokumentacionin e tyre sipas fushave specifike të inspektimit me ato unike, i cili do të bëjë të mundur dokumente unike inspektimi për të bashkërenduar veprimtaritë e Inspektorateve Shtetërore dhe kryerjen e inspektimeve të përbashkëta me qëllim që të ulët kosto administrative e subjekteve të inspektimit në lidhje me këtë aktivitet.

Për zbatimin e parimit të programimit të inspektimit mbi bazë risku, është punuar për hartimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe programimin e

inspektimeve. Hyrja e këtyre koncepteve të reja do të sjellë një planifikim më të mirë të burimeve njerëzore që kanë në dispozicion inspektoratet shtetërore, duke përqendruar inspektimin në ato subjekteve të inspektimit të cilat paraqesin rezikshmëri më të lartë në sigurinë publike.

Gjithashtu, Inspektorati Qendror në përmbushje të detyrimeve të veta ligjore që rrjedhin nga ligji i inspektimit ka kryer trajnime të inspektorëve të inspektorateve shtetërore për parimet bazë dhe procedurat e inspektimit sipas ligjit për inspektimit, si dhe përdorimit të dokumentacionit të ri për evidentimin e procesit të inspektimit, sipas një plani veprimi të hartuar për trajnimin e inspektoreve shtetërore, në bazë të nevojave të identifikuara për inspektoratet shtetërore. Për të vlerësuar veprimtarinë dhe punën e inspektorateve shtetërore dhe inspektorëve shtetërore, janë hartuar rregulla së përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre.

Inspektorati Qendror, për të realizuar koordinimin e efektshëm të inspektorateve shtetërore të caktuara për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, ka nxjerrë Udhëzimin nr. 65, datë 19.09.2014 “Për bashkërendimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, nga trupat inspektuese”. Në këtë mënyrë u mundësua zbatimi me efektivitetin i këtij ligji nga këto inspektorate shtetërore.

Pra, zbatimi i reformës ka sjellë përmirësime të të gjithë sistemit të inspektimit. Reforma ka synuar që nëpërmjet planifikimit mbi bazë risku, standardizimit të procedurës së inspektimit dhe informatizimit nëpërmjet Portalit “e-inspektimi” të rrisë transparencën e procesit dhe të parandalojë mundësinë e marrëveshjeve informale e korruptive të inspektorëve shtetërore dhe subjekteve të inspektimit në të gjitha fazat e procesit të inspektimit, që nga planifikimi i inspektimit e deri te apeli i masave administrative të vendosura nga inspektorët.

- Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës për veprimtarinë e inspektimit

Inspektorati Qendror, në përmbushje të funksioneve të tij, ka kryer mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, për zbatimin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese pranë subjekteve të inspektimit, në raport me ligjin e inspektimit dhe ligjeve të tyre sektoriale. Për të kryer një procedurë të saktë ligjore të mbikëqyrjes, u miratua Urdhri nr. 74, datë 30.12.2014, “Për Manualin e Mbikëqyrjes së veprimtarisë së inspektimit pranë Inspektorateve Shtetërore/Vendore dhe trupave të tjera inspektuese”, i inspektorit të Përgjithshëm, i cili bëri të mundur unifikimin dhe lehtësimin e procesit mbikëqyrës ndaj inspektorateve shtetërore. Kjo ka sjellë përmirësim edhe të procedurës së shqyrtimit të ankesave të ardhura në formë elektronike dhe zyrtare pranë Inspektoratit Qendror dhe të komunikimit me inspektoratet shtetërore përkatëse për evidentimin dhe zgjidhjen e tyre.

Aktivitet mbikëqyrës është realizuar pranë tre inspektorateve shtetërore, përkatësisht Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, Inspektorati Qendror Teknik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Nëpërmjet këtij aktiviteti mbikëqyrje është vlerësuar veprimtaria e inspektorateve shtetërore, me disa mangësi, si dhe janë raportuar problematikat e hasura, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese me qëllim përmirësimin dhe unifikimin e veprimtarisë inspektuese në të gjithë sistemin e inspektimit.

Forcimi i rolit mbikëqyrës të inspektoratit Qendror për zbatimin e ligjit të inspektimit dhe ligjeve të posaçme nga inspektoratet shtetërore për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit ka sjellë rritje të përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të aktivitetit të tyre në kryerjen e detyrave që i ngarkon ligji, si dhe ka siguruar standardizimin e veprimtarisë inspektuese.

Mbikëqyrja e inspektorateve shtetërore ka shërbyer edhe për identifikimin dhe përhapjen e praktikave inspektuese më të mira.

Nga mbikëqyrja e ushtruar pranë këtyre tre inspektorateve shtetërore ka rezultuar se: ligji nr.10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë", nuk ka gjetur plotësisht zbatim gjatë veprimtarisë së tyre inspektuese; në disa raste aktet administrative (Program Vjetor, Program Mujor, Autorizim, Njoftim Autorizimi, Procesverbal Inspektimi, Procesverbal Konstatimi dhe Vendim për Dënim Administrativ) nuk ishin të plotësuar konform ligjit për inspektimet, apo ishin kryer edhe inspektime pa Autorizim; Programet Vjetore të Inspektimit, nuk kanë ndjekur në të gjitha rastet rrugën ligjore për miratimin nga autoriteteve përgjegjëse; gjatë plotësimit të dokumenteve të veprimtarisë inspektuese ka patur disa pasaktësi në shpjegimin e fakteve dhe referimit të bazës ligjore; mungesa në strukturat organizative të punonjësve që do të përgjigjen për menaxhimin e portalit "e-Inspektimi" dhe faqen zyrtare publike dhe jopublike të tyre; mungesa në programimin e inspektimeve sipas metodologjisë bazuar në vlerësimin e riskut dhe në kategorizimin e subjekteve me risk më të lartë.

Pas mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të këtyre inspektorateve shtetërore, Inspektorati Qendror ka dhënë edhe rekomandimet përkatëse, me qëllim përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen, si: programi i veprimtarisë së inspektimit nga inspektoratet shtetërore duhet të ndërtohet duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin për inspektimin periodik sipas ligjeve të posaçme, si dhe të ndjekë procedurën ligjore të miratimit nga autoritetet përgjegjëse të tyre pasi të kenë marrë më parë mendim këshillimor për bashkërendim të tyre, pranë Inspektoratit Qendror; të përdorin formatet standarde të miratuara të veprimtarisë inspektuese; çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit, si dhe çdo akt administrativ i nxjerrë prej tyre, i cili ka lidhje me veprimtarinë inspektuese, duhet të këshillohet më parë nga Inspektorati Qendror; evidentimin e saktë të bazës ligjore sipas dispozitave ligjore në fuqi gjatë procesit të plotësimit të dokumentacionit në fushat përkatëse të inspektimit; organizimi i inspektorateve shtetërore sipas kërkesave të ligjit për inspektimin; hartimi i ligjeve përkatëse në ato fusha ku kjo ka dalë si domosdoshmëri, si dhe përditësimi i rregulloreve teknike; përmirësim i procedurës së regjistrimit të gjobave dhe ankimit deri në ekzekutimin e tyre.

Gajtë vitit 2014 numri i përgjithshëm i proceseve të inspektimit të kryera nga të gjithë inspektoratet shtetërore është 160.058 inspektime; ndërsa numri i përgjithshëm i masave administrative të marra prej tyre shkon në 421.252 masa administrative.

- Implementimi i Portalit unik të inspektimeve "e-Inspektimi"

Në lidhje me implementimin e Portalit unik të inspektimeve "e-Inspektimi" për tre Inspektoratet pilot, përkatësisht Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, është intensifikuar puna për bërjen funksional të tij për këto tre inspektorate shtetërore. Gjatë vitit 2014, këtyre tre inspektorateve shtetërore ju shtua edhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), për vetë rëndësinë e madhe që ka fusha e inspektimit të ushqimit, në sigurinë publike. Me financim nga buxheti i shtetit u realizua pajisja e inspektorëve të AKU me 198 paketa inspektimi, si dhe u përmirësua infrastruktura hardëare e portalit unik të inspektimeve "e-Inspektimi", nga server-a virtual në servera të dedikuar fizik të kolokuar, instaluar dhe konfiguruar tashmë në ambientet e Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Ky përmirësim ishte i domosdoshëm për zhvillimin optimal të proceseve të punës nga të gjithë Inspektoratet Shtetërore.

Drejtorja Rajonale e Tiranës e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore tashmë po e përdor këtë Portal në kryerjen e veprimtarive inspektuese, duke filluar që prej muajit Korrik 2014 dhe në vazhdimësi janë programuar në sistem rreth 1190 inspektime. Inspektoët e

degëve rajonale të këtij inspektorati shtetëror janë trajnuar në lidhje me përdorimin e Portalit në inspektime dhe aktualisht po punohet për programimin e inspektimeve për vitin 2015. Inspektimet e kryera nëpërmjet këtij portali kanë shkurtuar afatet kohore të qëndrimit të inspektorëve pranë subjektit, kanë rritur efektivitetin dhe transparencën e procesit. Ndërsa, tre inspektoratet e tjera shtetërore, të sipërpërmendura, ende nuk janë përdorues të tij, për arsye se përfshirja në systemin “e-Inspektimi” ka qënë në vartësi të ristrukturimit të tyre dhe të hartimit të dokumenteve të inspektimit sipas fushave që ato mbulojnë.

Portali “e-Inspektimi” konsiderohet si një ndër elementet kryesore për një qeverisje të hapur dhe transparente. Për komunikimin e Portalit unik “e-Inspektimi” me sisteme të tjera dhe krijimin e regjistrit elektronik të akteve inspektuese si pjesë e bashkësisë së regjistrave elektronikë në vend, Inspektorati Qendror ka nënshkruar dy Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 195 me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe nr. 161 me Qendrën Kombëtare të Licensimit, për të shkëmbyer të dhënat me këto institucione, si dhe është duke u finalizuar Memorandumi i Bashkëpunimit midis Inspektoratit Qendror dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili synon komunikimin e sistemit “e-Inspektimi” me sistemin e dixhitalizuar të tatimeve për shkëmbimin e të dhënave.

- Vlerësimi dhe testimi i inspektorëve shtetëror

Gjithashtu po vazhdon puna për unifikimin e procedurave të vlerësimit mbi bazë performance për inspektoratet shtetërore. Meqenëse kapacitetet njerëzore janë të dobëta, gjë e cila është edhe një nga arsyet e mosfunksionimit të plotë të ligjit të inspektimit, Inspektorati Qendror po punon për hartimin dhe zbatimin e procedurave të trajnimit dhe çertifikimit të inspektorëve. Aktualisht në këtë drejtim ekziston një ngërç me Departamentin e Administratës Publike, si rrjedhojë e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, për hartimin dhe miratimin e rregullores për intervalet e testimit periodik të inspektorëve, rregullat e hollësishme për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedure. Kjo rregullore propozohet në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” duke plotësuar kuadrin ligjor lidhur me testimin e inspektorëve shtetërorë.

Inspektorati Qendror ka përditësuar Regjistrin Kombëtar Elektronik të Inspektorëve shtetërorë në detyrë, i cili mund të konsultohet online në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror.

Më poshtë jepet i detajuar raportimi i veprimtarisë së inspektorateve shtetërore sipas ministrive të linjës.

RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT

1) Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Punëve të Brendshme, në fushën e juridiksionit që mbulon përfshin dy inspektorate shtetërore, si më poshtë:

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2014. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit pranë INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse¹.

Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit (PMNZSH)


Drejtoria e PMNZSH-së funksionon bazuar në Ligjin nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”. Në misionin e saj ka sigurinë nga zjarri dhe për shpëtimin në raste zjarri dhe fatkeqësish natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut të pronës, njerëzve, kafshëve, angazhimin dhe koordinimin e strukturave të niveleve të ndryshme qeverisëse. Funksioni i saj kryesor është organizimi dhe drejtimi i punës për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregulloreve për mbrojtjen e jetës së njerëzve e të pronës nga rreziku i zjarrit dhe jep asistencë teknike në këtë fushë.

Gjatë viti 2014, PMNZSH ka zhvilluar aktivitete që kanë synuar të rrisin sigurinë publike, për fushat që mbulon ky institucion. Është realizuar me grup kontrolli nga drejtoria me urdhër ministri në qarqet Shkodër, Dibër, Gjirokastrë, Tiranë, Elbasan, Berat për dokumentacionin e shërbimit zjarrfikës dhe detyrat e lëna për stërvitjen e përditshme.


U hartua marrja e masave për përballimin e situatave të nxehta të verës për të përballuar situatat e mundshme. Është zhvilluar takim me shërbimin zjarrfikës Grek, i mbajtur në Janinë për zbatimin e marrëveshjes në stinën e nxehtë të verës dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Inspektimet janë përqendruar në objekte si: 200 aktivitete Civile (banimi), 1260 aktivitete shërbimi (dyqane, salla, magazina, etj.), 338 aktivitete akomoduese turistike, 1369 aktivitete Didaktike (shkolla, kopshte, çerdhe), 613 aktivitete tregtimi me lëndë lehtësisht të djegshme , aktivitete artizanale, 136, si dhe 65 objekte historike, artistike të destinuara (muze, galeri, ekspozita), 46 objekte të destinuara për impiante sportive, 344 depozita gazi të fiksuar me kapacitet deri në 5m³ 62 depozita gazi të fiksuar me kapacitet mbi 5m³, 628 impiante për shpërndarje e karburanteve , 317 objekte administrative , sipas grafikut më poshtë:

¹ Neni 16, pika e) e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe Seksioni IX, pika 3 e VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit “e-inspektimi”.



Gjatë ushtrimit të inspektimeve të mësipërme janë marrë masa administrative, përkatësisht: 415186 konstatime me procesverbal (dënim me gjobë), 54 bllokime, 300389 akte ekspertize (për zjarret e rëna), 159851 akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri), 23551 ripërtëritje akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri), 197 vërtetime zjarri, 152372 miratime projekti për PMNZSH. Nuk ka pasur asnjë rast të kallëzimit penal.



Gjatë vitit 2014 stafi i PMNZSH ka zhvilluar takime dhe trajtime të ndryshme edhe jashtë vendit mbi “Rritjen e njohurive mbi vlerësimin e rreziqeve të zjarreve”; trajnimit “Mbi praktikatat më të mira të bashkëpunimit midis vendeve të Evropës Juglindore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut”; ushtrime me skenar “Aksident automobilistik në rrugë nacionale”; tryezë e rumbullakët me temë “Për zjarret në pyje”.

2) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH), zhvillon aktivitetin e vet në bazë të Vendimit nr. 61, dt. 24.2.1981 “Për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor” dhe ligje të tjera specifike. Kjo Drejtori, është në varësi të ministrisë që mbulon transportet. Bazuar në strukturën organizative të miratuar nga Kryeministria dhe Urdhrit të Ministrit nr. 154, datë 27.10.2010 “Rregullore e brendshme e funksionimit të DIH”, DIH ka për detyrë kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe garantimin e zbatimit të rregullave për:

- a) mbrojtjen, mirëmbajtjen, remontin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës hekurudhore;
- b) lëvizjen e sigurt të trenave;
- c) kontrollin teknik të mjeteve lëvizëse gjatë shfrytëzimit të tyre;
- ç) të gjitha procedurat e ndjekura gjatë pranimin për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore.

Kjo drejtori ka në përbërjen e saj tre sektorë: sektori i Teknikës, sektori i Lëvizjes dhe sektori i Financës dhe Administratës.

Gjatë vitit 2014 janë evidentuar 16 pika me rrezik për lëvizjen e trenave. Me gjithë masat e marra gjendja paraqitet shqetësuese në disa segmente të vijës hekurudhore dhe konkretisht në zonën Lushnjë – Fier ka shqetësime lidhur me forcimin e mureve mbrojtëse të useqeve nga rënia e dherave mbi trase në periudhën e shirave. Aktualisht shpejtësia e lëvizjes së trenave vazhdon të jetë e kufizuar deri në 5 km/orë.

Gjithashtu ka patur 7 raste të pezullimit të lëvizjes së trenave nga shkak i mbulimit të trasesë hekurudhore nga ujërat.

Nga inspektimet e ushtruara në vijat hekurudhore të stacioneve, gjendja teknike e ndërruesve hekurudhorë vazhdon të jetë e dobët si pasojë e prezencës së traversave special të kalbura dhe konsumit apo mungesës së aksesorëve e pjesëve të ndërrimit. Për këto arsye shpejtësia e lëvizjes së trenave vazhdon të jetë në kufinj të minimal nga 5 – 15 km/orë në ndërrueset e hyrje – daljeve të stacioneve hekurudhore të zonave Vorë – Bajzë, Rrogozhinë – Vlorë dhe Rrogozhinë – Librazhd.


Në degëzimet hekurudhore, përse i përket gadishmërisë së tyre për kalimin e manovrimin e trenave të mallit, gjendja është shumë e dobët. Gjatë vitit 2014 në degëzimin Vidhas – Ndërmarrja e Prodhimit të Çelikeve (NPÇ) Elbasan kanë ndodhur 8 raste të daljes nga shinat të mjeteve hekurudhore me pasojë vetëm vonesa në lëvizjen e trenave dhe përpunimin e vagonave të huaj me mall importi.

Nga Njësia e Menaxhim Biznesit të Infrastrukturës Hekurudhore gjatë vitit 2014 me mundësitë financiare që ka patur në dispozicion janë marrë masa duke vendosur traversa druri dhe betoni. Nga ana e DIH është rekomanduar që shpërndarja e këtyre traversave të jetë efikase, kryesisht në eliminimin e pikave të dobëta dhe në kthesat problematike të vijës hekurudhore. Kështu gjatë vitit 2014 janë eliminuar 7 pika me ulje shpejtësie, por ekzistojë akoma 9 pika me ulje shpejtësie nga 5 – 10 km/orë. Kështu janë vendosur 326 copë traversa dhe po vazhdon puna për vendosjen e 156 traversave të tjera.

Çdo vit Njësia e Menaxhim Biznesit të Infrastrukturës Hekurudhore kryen kontrollin e tërë vijës hekurudhore. Gjatë vitit 2014 është kryer kontrolli 6-mujor në lokomotivat që janë në shfrytëzim duke përqendruar vëmendjen në gjendjen teknike të pajisjeve të sistemit të frenimit, të sistemit xhenerik dhe funksionimit normal të aparatit të regjistrimit të shpejtësisë. Gjithashtu, është kryer kontrolli 6-mujor në vagonat e mallrave që janë në qarkullim, kryesisht vagonat e hapur, prodhim vendi, tip P-9 dhe vetëshkarkues duke përcaktuar gjendjen teknike faktike dhe masat për eliminimin e mangësive në vagona të veçantë. Çdo 2 muaj janë kryer kontrollet në vagonat e udhëtarëve që janë në qarkullim duke përcaktuar për çdo vagon gjendjen teknike të sistemit të

lëvizjes e të frenimit.

Gjatë vitit 2014 kanë ndodhur 7 raste të avarive hekurudhore nga 13 raste të avarive të ndodhura gjatë vitit 2013.



Në lidhje me masat administrative, për vitin 2014, gjatë ushtrimit të kontrolleve në trena apo në rastet e shërbimit për shkelje të dispozitave të Kodit Hekurudhor e rregullave të sigurimit të lëvizjes, inspektorët e DIH kanë dhënë 73 masa administrative me gjobë, krahasuar me 42 të tilla gjatë vitit 2013.

3) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), zhvillon aktivitetin e vet sipas ligjit nr. 9875 datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar me ligjin nr. 10217 datë 21.01.2010 “Për disa ndryshime në ligjin 9875 datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, si dhe VKM nr. 1576 datë 17.10.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”. Metrologjia përfshin tre fushat e njohura si: metrologjia shkencore, metrologjia industriale dhe metrologjia ligjore.

Metrologjia ligjore lidhet me aktivitetin që rrjedh nga fushat e rregulluara për njësitë e matjeve, metodat dhe instrumentet e matjeve në transaksionet tregtare, mbrojtjen e konsumatorëve, mbrojtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mjedisit.

Gjatë vitit 2014 veprimtaria e inspektimit të Drejtorisë së Inspektimit Metrologjik (DIM), e cila gjendet brenda strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, rezulton në fushat më të ndryshme për konsumatorin, si: Hidrokarburet, Parapaketimet, Baret, Tregjet e Lira dhe Marketet, Taksitë, Peshoret Automobilistike, etj.


Në fushën e hidrokarbureve janë kryer 1.149 inspektime në subjekte që tregtojnë me shumicë dhe pakicë hidrokarbure. Nga këto inspektime, në 35 subjekte inspektimi janë marrë masa administrative. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë bllokuar dhe u është kërkuar riverifikim për 930 pistoleta furnizuese.

Në fushën e produkteve të parapaketuara janë ushtruar 242 inspektime në subjektet prodhuese apo importuese, si dhe tregëtimit me pakicë apo shumicë të këtyre produkteve. Nga kontrollet janë kryer 900 testime dhe për 7 subjekte janë marrë masa administrative me gjobë.

Objekti i kontrollit në fushën e produkteve të parapaketuara ka qenë, vlerësimi i konformitetit të parapaketimeve dhe shisheve enë matëse në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për metrologjinë, si dhe plotësimi i kërkesave metrologjike të përshkruara në rregulloret, si dhe mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara në etiketë.

Gjatë vitit 2014 janë ushtruar 5.425 inspektime në subjekte që kishin në përdorim instrumenta matës të ndryshëm dhe të ndjeshëm për konsumatorin. Disa nga subjektet që janë kontrolluar janë: Markete, Furra Buke, Bulmetore dhe Dyqane Mishi, Bare dhe Restorante, Argjendari, Tregje të Lira, Fast Food, Taksi, Gomisteri, Farmaci, Posta Shqiptare dhe DHL, sipas grafikut të mëposhtëm:

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2014




Vlen për t'u theksuar së gjatë vitit 2014, për herë të parë, inspektimi ushtroi kontrolle në laboratorët e autorizuar nga DPM-ja për të kryer shërbime metrologjike. Inspektimi u krye në 8 labore të autorizuar nga 9 të tillë gjithsej.

4) Ministria e Arsimit dhe Sportit

Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), gjatë vitit 2014 ka zhvilluar veprimtarinë duke u mbështetur në planin vjetor 2014 dhe në prioritetet e MAS-it. Kjo veprimtari ka qenë në funksion të misionit për rritjen e cilësisë së shërbimit në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimit të zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë. Për këtë ISHA ka kryer inspektimin, vlerësimin, këshillimin dhe nxjerrjen e përfundimeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe ka inspektuar nivelin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin e lartë. Gjatë vitit 2014 u miratua struktura e re e ISHA, në të cilën u shtua Sektori i Mbikëqyrjes së Zbatimit të Legjislacionit në Arsimit të Lartë, i cili ka në fokus të veprimtarisë së tij kontrollin e zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private.

ISHA gjatë vitit 2014, ka kryer 493 inspektime, përkatësisht: 14 inspektime të plota, 28 inspektime tematike, 387 inspektime të orientuara, si dhe 64 inspektime mbi bazë të ankimimeve të ardhura në rrugë zyrtare.



Inspektimi në arsimin parauniversitar

Në bazë të planit vjetor janë kryer 14 inspektime të plota në institucionet e arsimit parauniversitar, si kopshte, shkolla 9-vjeçare, gjimnaze dhe shkolla profesionale, me një shpërndarje gjeografike të DAR/ZA-ve² në të gjithë vendin.

Janë kryer 28 inspektime tematike (12 kopshteve dhe 16 shkolla) me fokus zbatimin e Dispozitave Normative 2013, për çështje si: drejtimi, administrimi e menaxhimi i këtyre

² DAR/ZA- Drejtori Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore.

institucioneve; kurrikula e zbatuar me elementët përbërës të saj; zbatimi i kodit të etikës së mësuesit; mjedisi psiko-social i të nxënësve.

Grupet inspektuese të ISHA-s, kanë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin shkollat ndaj rasteve të dhunës dhe parandalimin e tyre, si dhe kanë propozuar edhe masa administrative ndaj rasteve ekstreme të dhunës, përkatësisht: masën “*Vërejtje*” për 6 mësues në shkollën 9-vjeçare “Qemal Stafa”, ZA Krujë dhe masën “*Paralajmërim*” për 3 mësues të shkollës 9 vjeçare “Hasan Koçi”, DAR-i Durrës.

Janë zhvilluar 328 inspektime të orientuara për çështje si: planifikimi i punës për përgatitjen e nxënësve maturanë për provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2015; zbatimi i ligjshmërisë në shkollat jo publike; burimet njerëzore të DAR/ZA-ve.

Janë zhvilluar inspektime të orientuara për vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucionet arsimore private me kohë të pjesshme për procedurat e pranimit dhe plotësimin e dokumentacionit shkollor në përputhje me aktet ligjore. Inspektimi u krye lidhur me zbatimin e kriterëve të ligjshmërisë për plotësimin e dokumentacionit shkollor, regjistrimet dhe transferimet e nxënësve. Nga këto inspektime rezulton se në të gjitha shkollat e inspektuara, ka patur raste ku regjistrimi i nxënësve është kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Propozime për masë administrative për shkeljet e rënda të kërkesave ligjore të konstatuara në dokumentacionin shkollor (regjistra, amza, procesverbale të njëvlershmërisë së provimeve), të cilat përbëjnë mosplotësim të kushteve të licencimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit *i ka propozuar* Ministrin të Arsimit dhe Sportit heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë për 12 institucione me kohë të pjesshme. Bazuar në këto propozime të ISHA, Ministri i Arsimit dhe Sportit, vendosi mbylljen e këtyre shkollave nëpërmjet heqjes së licensës.

Në kuadër të inspektimeve të orientuara për vlerësimin e aktit të licencimit të shkollës private me kohë të pjesshme, u inspektua shkolla e mesme me kohë të pjesshme “Dituria” Kavajë, si institucion arsimor i palicensuar. U mor masa administrative *mbylljen* e kësaj shkolle private.

Janë zhvilluar inspektime të orientuara për vlerësimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucioneve arsimore jopublike 9-vjeçare dhe të mesme. ISHA inspektoi 145 institucioneve arsimore jopublike 9-vjeçare dhe të mesme, në të gjitha DAR/ZA-të e vendit. Gjymnazet e Tiranës u inspektuan për vlerësimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në plotësimin e dokumentacionit shkollor në mbylljen e vitit shkollor 2013-2014 dhe fillimin e vitit shkollor 2014-2015. U inspektuan gjymnazet: “Qemal Stafa”, “Arben Broci”, “Eqrem Çabej” dhe “Myslym Keta”. Bazuar në gjetjet e inspektimit u propozuan masat disiplinore Paralajmërim dhe Vërejtje.

Janë zhvilluar inspektime të orientuara të DAR/ZA-ve për vlerësimin e masave të marra nga DAR/ZA-të për fillimin e vitit shkollor 2014-2015, procedurat e emërimit të punonjësve arsimorë në DAR/ZA dhe në shkolla në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, gatishmërinë për mësim dhe të mjediseve shkollore, hartimin dhe zbatimin e rregullores së brendshme dhe hartimin dhe zbatimin e planit të zhvillimit profesional të punonjësve. Në emërimin e punonjësve jo në të gjitha DAR/ZA-të është bërë në përputhje me këto akte. Dosjet e punonjësve të DAR/ZA-ve, janë të plotësuara, përgjithësisht, me dokumentacionin e plotë, por në shumicën e rasteve, kanë bërë emërimet, transferimet paralele dhe largime nga puna të drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga inspektimi i dokumentacionit individual të mësuesve në disa DAR/ZA, ndër të tjera u evidentuan edhe 1984 mësues pa arsim përkatës, 2065 mësues jashtë profilin,

mësues të palicensuar, si dhe mësues mbi normat e lejuara nga aktet ligjore dhe nënligjore. Evidentimi i këtyre kategorive bëri të domosdoshëm reformimin e kapaciteteve profesionale në arsimin parauniversitar, duke nxitur nismën e MAS-it të titulluar “Mësues për Shqipërinë”.

ISHA ka kryer inspektime mbi bazë ankimi të mbërritura në MAS ose drejtpërdrejtë nga mësues, drejtues shkolle, prindër, nxënës, DAR/ZA, ku për problemet e konstatuara ka dhënë rekomandime për zgjidhjen e ankimeve. Ndërsa, për shkeljet e konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar ka dhënë masa administrative të tilla si: këshillim, qortim, vërejtje, vërejtje me paralajmërim, si dhe gjobë me vlerë gjysmën e pagës mujore.

Inspektimi në arsimin e lartë

Gjatë vitit 2014 ISHA ka realizuar dy lloje inspektimesh në institucionet e arsimit të lartë: inspektime të orientuara, në kuadër të procesit të verifikimit të kriterëve të ligjshmërisë dhe inspektime në kuadër të shqyrtimit të ankimeve.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2014, për një periudhë 3 mujore, u krye inspektimi në 59 institucione të arsimit të lartë, i cili u iniciua nga Ministri i Arsimit dhe Sportit. Në përfundim të këtij procesi, nisur nga shkeljet e konstatuara në këto subjekte, bazuar në aktet ligjore në fuqi, me qëllim rritjen cilësore të nivelit të këtyre institucioneve arsimore, inspektimet konkluduan në propozime për heqjen e licensës për 18 institucione të arsimit të lartë, pezullim aktiviteti deri në plotësimin e rekomandimeve në 13 prej tyre, plotësim dhe verifikim të rekomandimeve në 13 të tjera, heqje të licensës për 7 filiale të institucioneve të arsimit të lartë publik dhe të Akademisë së Arteve në Shkodër.


Për sa i takon inspektimeve me bazë ankimimi u trajtuan katër të tilla, në institucione publike të arsimit të lartë, të cilat kishin të bënin kryesisht me procesin e rekrutimit dhe të masave të marra ndaj stafit akademik, si dhe regjistrimin e studentëve në të tri ciklet e studimit.

Në këtë mënyrë ISHA ka kontribuar për realizimin e misionit të sistemit arsimor për një arsim cilësor dhe me akses të barabartë për çdo qytetar.

5) Ministria e Kulturës

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA) kryen mbikëqyrjen e tregut nëpërmjet inspektimit dhe marrjes së masave administrative për subjektet që nuk kanë përmbushur detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”. Gjatë vitit 2014 u miratua struktura e re e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit me Urdhër të Kryeministrit nr. 137, datë 28.3.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”.

Gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2014, ZSHDA ka kryer inspektime në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë, Gjirokastër dhe Shkodër, në 545 subjekte të kategorive si: bar-kafe, videoteka, shërbime telefonike (Call Center), pika shitje kompjuterësh, librari, fotokopje, televizione, radio, TV kabllorë dhe hotele, si përdorues të produktit intelektual, nga të cilat u janë vendosur masa administrative me gjobë 48 prej tyre, në një shumë prej **6 500 000** lekë, si dhe janë lënë detyra për zbatimin e ligjit të sipërcituar.



Problemet e konstatuara gjatë këtyre inspektimeve kanë qenë, të tilla si:

- Për subjektet *bar-kafe dhe hotele*, iu është kërkuar që për muzikën që përcjellin në publik (brenda ambientit tregtar të tyre, të paraqesin autorizimet e tri Agjensive e Administrimit Kolektiv, të cilat operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Lidhur me këtë, mendimi i ZSHDA-së ka qenë se agjencitë duhet të arrijnë një marrëveshje të përbashkët për të ngritur një grup të vetëm të përfaqësuesve të tyre, për t'u paraqitur në subjekte (një përfaqësues i të gjitha agjencive të licencuara për subjekt). Por edhe pas realizimit në muajin Maj 2014 të disa takimeve

të ZSHDA-së me përfaqësues të tri agjencive të licencuara, lidhur me këtë kërkesë të zyrës për daljen e tyre në terren së bashku, kjo marrëveshje ka mbetur vetëm në diskutime dhe agjencitë nuk janë prononcuar më tej për këtë propozim të ZSHDA-së.

Për më tepër, është konstatuar, sipas deklarimeve të përfaqësuesve të subjekteve gjatë inspektimit, se këto agjenci dërgojnë në subjekte agentët e tyre të cilët prezantohen në subjekte si Inspektorë të ZSHDA, e cila ka dëmtuar rëndë figurën e Inspektorit të ZSHDA-së për shkak të sjelljes jo etike të tyre ndaj përfaqësuesve të subjekteve dhe për rrjedhojë humbje të besimit ndaj institucionit shtetëror të ZSHDA. Mbi këtë problem u është tërhequr disa herë vëmendja Agjensive, janë trajnuar përfaqësuesit e tyre në terren, si dhe u është kërkuar Agjensive bashkimi në një sportel të vetëm “ONE STOP SHOP”, me qëllim shmangjen e konfuzionit në treg.

- Për subjektet *videoteka*, ju është kërkuar që për produktet që tregtojnë të jenë të pajisur nga ana e producentëve me pullën e ZSHDA-së. Është konstatuar një sasi relativisht e konsiderueshme e mbajtësve fizikë (DVD) të produktit të huaj, kryesisht filmit. Problematikë mbetet mungesa e një distributori për filmin e huaj - produkt që potencialisht - shkarkohet nga faqet e internetit. Për këtë është lidhur Memorandumi i Mirëkuptimit me AKEP-in³ dhe në varësi të ankesave të titullarëve të së drejtës së autorit, janë arritur të bllokohen rreth 36 faqe interneti që mundësojnë shkarkimin e këtij produkti.

- Subjekteve *pika shitje kompjuterash dhe shërbime telefonike (Call Center)*, ju është kërkuar që tregtimi i pajisjeve kompjuterike (PC, Laptop) në rast se kanë qenë me sisteme (programe) të instaluar, të bëhet vetëm nëse këto programe janë të licencuara. Ndërsa për kategorinë tjetër Shërbime Telefonike (Call Center), për kompjuterët që kanë në përdorim, iu është kërkuar t'i kenë të pajisur me licencat përkatëse për ato programe që shfrytëzojnë. Në këto subjekte, problematike është pjesa e kompjuterëve të përdorur të ardhur nga jashtë vendit, të cilët janë të pajisur me pulla OEMI⁴, që nuk kanë kushtet e duhura për t'u klasifikuar si të licencuar pasi: ka ndërhyrje në sistemet operative; bëhen formatimet me sisteme operative pirate; nuk plotësohen kushtet për të bërë *upgrade* dhe *doëngrate* këtyre sistemeve, si dhe përgjithësisht sistemet origjinale janë në gjuhën gjermane, ndërsa sistemi që përdorin është në gjuhën angleze.

Për të rregulluar këtë problem relativisht të madh lidhur me luftën kundër piraterisë në fushën e softëare-ve, zgjidhja më e mirë në këtë fushë do ishte **licencimi i një operatori lidhur me pullat për kompjuterët e përdorur**, një praktikë që e kanë edhe shumë vende të tjera të botës.

- Subjekteve *librari dhe pika fotokopje*, ju është bërë me dije se tregtimi i librit duhet bërë duke respektuar ligjin shqiptar për të drejtën e autorit, pra libri të ketë elementët përkatës si çmim, tirazh, ISBN, etj. Lidhur me pikat e fotokopjimit, subjekteve ju është bërë me dije se fotokopjimi i librit ndalohet rreptësisht nga ligji për të drejtat e autorit. Gjatë inspektimit të pikave të fotokopjimit të ndodhura pranë fakulteteve të UT, është konstatuar fotokopjimi i librave shkollorë universitare, ku profesorë të ndryshëm u japin studentëve librat e autorëve të tjerë për të fotokopjuar, madje të lidhur me pika të caktuara, për t'i fotokopjuar për studentët.

Për të rregulluar këtë problem në fushën e fotokopjimit të librit, një zgjidhje do të ishte **pagimi i një tarifë aforfe**, që pikat e fotokopjimit të paguajnë ose **me sistem vetëdeklarimi** se cilët libra janë fotokopjuar. Çështja është se ku do të paguhet kjo tarifë, duke qenë se shpërblimi për riprodhimin reprografik është, sipas instrumentave ndërkombëtarë të fushës, i parashikuar për t'u mbledhur vetëm nëpërmjet një agjencie të administrimit kolektiv dhe për veprat letrare, ku përfshihen tektet mësimore, por që nuk ka agjenci të tillë të licencuar në RSH.

Lidhur me këtë fenomen, është zhvilluar në Ministrinë e Kulturës një tryezë e përbashkët me Universitetet, ku janë ftuar edhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për të

³ AKEP, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

⁴ Licensë Windows

parashtruar detyrimet e ligjit lidhur me këtë kategori produkti intelektual. Pas organizmit të këtij takimi, inspektorët e ZSHDA-së kanë inspektuar përsëri pikat e fotokopjimit pranë universiteteve dhe fakulteteve të UT-së, gjithashtu edhe në zonën e gjerë pranë Qytetit Studenti dhe nuk është konstatuar përdorim i pautorizuar lidhur me këto vepra. Por ndërhyrja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit duhet të jetë në vijimësi, për të ndërgjegjësuar të gjitha shkollat e të gjitha niveleve, që të respektohet ligji për të drejtat e autorit për përdorimin e teksteve mësimore.

- Në kategorinë e subjekteve *TV valorë, TV Kabllorë dhe Radio* është konstatuar një problematikë e gjerë, si vështirësia e gjetjes së adresës e mos hapja e detyrës të ambjenteve ku subjektet ushtrojnë veprimtarinë. Për sa i përket respektimit të ligjit në këtë kategori subjektsh duhet theksuar se pjesa më e madhe ushtrojnë aktivitetet duke mos qenë të licencuara nga AMA⁵. Këtij institucioni i është kërkuar vënia në dispozicion e data-base të të gjithë subjekteve OSHMA⁶, që operojnë në territorin e RSH-së.

Për këtë kategori përdoruesish është i nevojshëm bashkëpunimi me Policinë e Shtetit duke qenë se gjatë inspektimeve, ka pasur jo pak reagime negative ose mungesë të theksuar etike nga ana e përfaqësuesve të këtyre subjekteve, gjë e cila ka sjellë pengesë në procesin e inspektimit dhe marrjen e masës në rast të konstatimit të shkeljes. Bashkëpunimi me organet e policisë, ka qenë me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, në kuadër të operacionit “Mërkuri i Bardhë 2” (periudha 30.09.2014 - 10.10.2014), të organizuar edhe me ndihmën e Interpolit, ku janë sekuestruar pajisjet që shërbenin për ushtrimin e përdorimit të pautorizuar të produktit intelektual.

Gjatë muajit dhjetor 2014 këtyre subjekteve iu është dërguar nga ZSHDA-ja njoftimi – rikujtesë për zbatimin e detyrimeve ligjore, si dhe iu është lënë afati 30 ditor për paraqitjen e autorizimeve nga titullarët e së drejtës, duke synuar marrjen e masës në varësi të përgjigjes/dokumentacionit që do të paraqesin këto subjekte. Po e njëjta procedurë është ndjekur lidhur me subjektet hotele, anëtare të shoqatës ATA⁷.

Objektivat e vitit 2015

Bazuar në organikën e re të ZSHDA-së, pasi janë emëruar të gjithë inspektorët e qarqeve, do të kryhet inspektimi i zonave të cilat nuk janë mbuluar më parë, lidhur me një kategori të rëndësishme, siç është vepra letrare, në shtëpitë botuese, librari dhe shtypshkronja, duke qenë se autorët shpesh janë ankuar se kontrata/marrëveshja me shtëpitë botuese ka qenë për një periudhë dhe tirazh të caktuar dhe shtëpitë botuese ose shtypshkronjat kanë mundësinë të ribotojnë veprën, në mënyrë të paautorizuar përtej tirazhit ose periudhës të kontraktuar me autorin.

⁵ Autoriteti i Medias Audiovizuale.

⁶ Organizata Shërbimi Audioviziv

⁷ Albanian Tourism Agency – Shoqata Shqiptare e Turizmit

6) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, (ISHPSHSH), vepron në bazë të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë e shëndetit në punë” dhe ka 12 degë rajonale sipas qarqeve me 113 inspektorë me një mesatare 110 inspektime në vit për çdo inspektor. ISHPSHSH është përgjegjës për inspektimin e strukturave të shërbimit social rezidencial, jo rezidencial, publik dhe privat për respektimin e standardeve ligjore të miratuara.

Drejtoria e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka në përbërje katër Drejtori, si më poshtë:


- 1) Drejtoria e Inspektimit për Marrëdhëniet e Punës dhe Statistikën
- 2) Drejtoria e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- 3) Drejtoria e Standardeve të Shërbimeve Shoqërore
- 4) Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme

Gjatë vitit 2014 ISHPSHSH ka përqendruar punën e vet në ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve të punës, përmirësimin e procesit të inspektimit sipas parimeve të ligjit të ri për inspektimin dhe bërjen e tij më eficient në të gjitha drejtoritë rajonale, përcaktimin e prioritetëve të kontrollit, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe realizimin e inspektimeve të përbashkëta. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë kryer trajnime dhe janë organizuar seminare me pjesëmarrjen e të gjithë inspektorët shtetërorë të punës për njohjen e kuadrit të akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

ISHPSHSH ka përfunduar hedhjen e procedurës dhe dokumentacionin në Portalin “e-Inspektimi” dhe ka filluar hedhjen e gjetjeve të inspektimit në kohë reale.

Gjatë vitit 2014, janë kryer gjithsej 10890 inspektime, ku 82% e zënë inspektimet e programuara, nga të cilat 10817 (99%) janë inspektime në subjekte private. Inspektimet janë kryer sipas fushave: të programuara 8930 ose (82%) , tematike 1742 ose 16%, për aksidente në punë 109 (ose 1%), dhe ato për shkak ankese 109 (ose 1%). Numri i punëmarrësve është 174240, me mes.punm/subjekt 16, punëmarrës femra 44.6%, punëmarrës që punojnë me kohë të pjesshme 678, punëmarrës nën 18 vjeç 265 dhe punëmarrës të huaj 2236; subjekte private të inspektuara 10817 (99% e totalit të subjekteve), punëmarrës në subjektet private 167603. Nga vetë natyra e aktiviteteve ekonomike që operojnë në Shqipëri janë aktivitetet tregtare që zënë peshën më të madhe të aktiviteteve të inspektuara, duke zënë 50% të totalit të kontrolluar gjatë vitit.

Këto inspektime kanë synuar evidentimin e rasteve të informalitetit duke dhënë kontribut të vlefshëm në formalizimin e punësimit.




Orientimi i drejtë i inspektimeve të programuara dhe tematike ka çuar në rritjen e evidentimit të punëmarrësve informal në subjektet e licensuara, krahasuar me të dhënat e një viti më parë. Kështu ka një rritje të ndjeshme me gati 5 herë të punëmarrësve informal të evidentuar në inspektimet tematike, si dhe rritje të kësaj kategorie punëmarrësish në inspektimet e programuara, apo në inspektimet për shkak ankese, ku një vit më parë kjo shifër ishte 3.

Gjatë vitit 2014, orientimi i drejtë i inspektimeve, ka çuar në rritjen e evidentimit të punëmarrësve që punojnë në turne të dyta, të treta, ditët e pushimit apo festave zyrtare krahasuar kjo me këto tregues të një viti më parë. Janë 30 mijë punëmarrës të kësaj kategorie evidentuar më shumë se një vit më parë.

Gjatë inspektimeve janë evidentuar dhe raportuar në organet e tatim – taksave 2886 subjekte inspektimi krejtësisht informale ku rezulton të punonin **4638** punonjës të pasiguruar.

Përsa i përket informalitetit, numri më i madh i punëmarrësve të pasiguruar është evidentuar në inspektimet e kryera në subjektet e licencuara me aktivitete si: tregti, hotel-bar-restorant me 43% të totalit të informalitetit, ndërmarrje prodhuese me 21% të totalit të informalitetit, në ndërtim me 13% të totalit të informalitetit, si dhe në aktivitete të tjera. Punëmarrës të pasiguruar në subjektet e licencuara janë 1757, ku 1127 ose (64.2%) e zënë punëmarrës meshkuj, dhe 630 ose (35.8%) janë punëmarrëse femra të pasiguruara. Numri i punëmarrësve informalë në 12 degët rajonale, evidentuar gjatë inspektimeve në subjekte të licencuara rezulton të jetë më i lartë në degën rajonale Vlorë, me 35% të totalit të informalitetit të evidentuar, dhe më i ulët në Gjirokastrë, Shkodër, Elbasan Fier.



Marrëdhënia e punës e finalizuar në kontratë individuale pune është 44.6% e punëmarrësve femra dhe 55.4% e punëmarrësve meshkuj, ndërsa referuar 12 degëve rajonale, përqindja më e madhe e punëmarrësve me kontrata individuale evidentohet në Fier, me 99.1% e totalit të punëmarrësve të evidentuar, dhe përqindja më e ulët e punëmarrësve me kontrata individuale evidentohet në Kukës me 78.3% dhe Vlorë me 88.7%.

Gjatë inspektimeve janë evidentuar edhe problematika që kanë të bëjnë me pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore mbi pagën minimale, kohëzgjatjen javore e punës, pagesat e pushimeve vjetore, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, punëmarrësit me kohë të pjesshme, punësimin e fëmijëve, subjektet që punojnë me substanca të rrezikshme, sëmundjet profesionale të punëmarrësve, shërbimin mjekësor në ndërmarrje.

Punëmarrës me aftësi të kufizuar që punojnë janë 127, punëmarrës të huaj që punojnë 2236, dhe punëmarrës të huaj pa leje pune 27, punëmarrës që punojnë me kohë të pjesshme 551, punëmarrës që kryejnë punën në shtëpi 2.

Punëmarrës nën 18 vjeç janë gjithsej 265, nga të cilët në ndërmarrje prodhuese 58%, përpunim peshku 12%, ndërtim 13%, tregti 1% dhe aktivitete të tjera 16%.

Për vitin 2014, gjatë inspektimit janë evidentuar gjithsej 6395 punonjës ilegalë, të cilët përveçse të pambrojtur janë njëkohësisht dhe kontribues të munguar në skemën e sigurimeve shoqërore. Për shkeljet e konstatuara janë sanksionuar 110 subjekte me masa administrative gjobë, që përfshin vetëm 1.01% të subjekteve të inspektuara, me vlerë 32.878.000 lekë, ku aktivitetet e ndëshkuara me gjobë rezultojnë ato aktivitete ku ka pasur aksidente në punë.

Lidhur me aksidentet në punë, gjatë vitit 2014 në të gjitha llojet e aktiviteteve janë raportuar 120 raste të aksidenteve në punë, nga të cilat janë konstatuar 111 raste, ku kanë mbetur të aksidentuar 121 punonjës, nga të cilët 33 kanë përfunduar me humbjen e jetës. Sektorët më të prekur nga aksidentet janë: ai i minierave me 29.8% të rasteve, ndërmarrjeve prodhuese, elektrike, gaz, ujë, ndërtimi, shërbime. Aksidentet që lidhen direkt me punën, duke përjashtuar aksidentet në miniera dhe në rrugë, përbëjnë 63.6% të rasteve të aksidenteve të ndodhura. Ndaj 26 subjekteve janë vendosur masa administrative gjobë për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, apo mosnjohim të aksidentit në punë pranë ISHPSHSH.

Përsa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë në rang vendi janë monitoruar 208 subjekte, me aktivitet ndërtim dhe prodhim materiale ndërtimi, ku janë lënë detyra për pajisjen dhe përdorimin e tyre nga punëmarrësit me pajisjet mbrojtëse individuale në 121 subjekte. Në 3 subjekte është lënë masa urgjente e pezullimit të punës, në 6 subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre ndërtues të cilët nuk kanë reflektuar brenda afatit kohor të përcaktuar nga inspektorët e punës, u është hapur procedura e inspektimit. Në 3 subjekte është marrë vendim me sanksion në vlerën e 300.000 lekëve, për arsye se punëdhënësi nuk ka reaguar për përmirësimin e situatës në subjektin e tij.

Përsa i përket shërbimit mjekësor në punë rezulton se numri i mjekëve për periudhën Janar – Dhjetor 2014 është 1187 mjekë, ndërsa kontrolli periodik i punëmarrësve ekziston në 2151 subjekte dhe janë deklaruar 1853 punëmarrës me sëmundje profesionale, nga 3890 punëmarrës të diagnostikuar në vitin 2013. Pra, për vitin 2014 kemi ulje të numrit të punëmarrësve të diagnostikuar me sëmundje profesionale. Numri i punëmarrësve që punojnë në vende pune të rrezikshme është 13223, ndërsa numri i punëmarrësve që punojnë drejtpërdrejt me substanca të rrezikshme është 3271.

Për vitin 2014 kemi një rritje të konsiderueshme të Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, dhe ekzistencës së dokumentit të vlerësimit të riskut, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të përkujdesit shoqëror nëpërmjet procesit të kontrollit të vazhdueshëm të standardeve në subjektet publike dhe jopublike që operojnë në fushën e përkujdesit shoqëror.

Gjatë vitit 2014 janë kryer aktivitete në kuadër të javës Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë me mbështetjen e projektit IPA-2010, ku është realizuar spoti publicitar në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjithashtu, në zbatimin e Ligjit Nr. 75/2014 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, nga inspektimet e kryera në terren nuk ka pasur shkelje të këtij ligji.

Për vitin 2015 ISHPSHSH do të vazhdojë procesin e ndërgjegjësimin të popullatës për rëndësinë e inspektimit të marrëdhënieve të punës, identifikimin e praktikave të mira për sigurinë e shëndetin në punë, promovimin e një kulture parandaluese, realizimin e inspektimeve të përbashkëta për implementimin dhe zbatimin e standardeve për përmirësimin e procesit të inspektimit.

7) Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë, në fushën e juridiksionit që mbulon përfshin tre inspektorate shtetërore, si më poshtë:

1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, (ISHSH), ushtron veprimtarinë e tij bazuar në VKM nr. 241, datë 27.03.2013 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”. ISHSH-ja ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është organizuar në drejtori Drejtoritë Rajonale Shëndetësore të qarqeve dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve përveç qarkut të Tiranës ku është në funksionim dega rajonale e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Me përjashtim të kësaj të fundit, degët rajonale të 11 qarqeve të tjera kanë filluar nga funksionimi me datë 1 janar 2015.

Gjatë vitit 2014, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka zhvilluar aktivitetin e vet sipas planit vjetor dhe në përmbushje të misionit për ruajtjen e normave optimale të shëndetit publik. Puna është përqendruar në përmirësimin e vazhdueshëm të indikatorëve shëndetësorë dhe të performancës së saj, duke zhvilluar aktivitete të koordinuara të shërbimeve dhe sektorëve, në përmbushje të prioritetëve dhe objektivave kryesore si: monitorimi i vazhdueshëm i indikatorëve të higjienës mjedisore si ajri, uji, toka, higjiena komunale e siguria ushqimore; promovimi i shëndetit dhe marrja e masave parandaluese për sëmundjet e ndryshme.

Fushat kryesore të veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë: Inspektimi Spitalor, Inspektimi Ambulator, Inspektimi Sanitar, Inspektimi Stomatologjik, Inspektimi Veterinar dhe Inspektimi për mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese dhe Jojonizuese.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor për shkak të mbivendosjes së ligjeve sektoriale, që krijojnë problematikë dhe ngarkesë për subjektet, si rrjedhojë e inspektimit të dyfishtë. Ligjet sektorale që kanë mbivendosje janë Ligji nr. 8025, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rezatimet jonizuese” (i ndryshuar) dhe Ligji nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për rezatimet jojonizuese” (i ndryshuar) dhe mbivendosja në këtë rast ndodh me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet, të cilët kanë në funksion si liçensimin, ashtu edhe inspektimin e subjekteve, ndërkohë që pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ka inspektorë të kualifikuar në fushën e rezatimit që mund të merren me procesin e inspektimit të kësaj fushe.

Gjatë vitit 2014 janë kryer inspektime për Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” i ndryshuar, janë kryer 10 proçese inspektuese. Ndërkohë për inspektimet e festave të fundvitit janë kryer 7 proçese inspektimi.

2. Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2014. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit pranë INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse⁸.

⁸ Neni 16, pika e) e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe Seksioni IX, pika 3 e VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit “e-inspektimi”.

3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet vepron në zbatim të ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar, dhe ligjit Nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese” dhe ka mision kryesor të përgatisë dokumentet ligjorë për mbrojtjen e punonjësve, publikut dhe mjedisit nga efektet e rrezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare si të ANEA-s dhe BE-së. Objekt i veprimtarisë së saj, është licencimi i veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, pajisja me akt miratimi i veprimtarive me burime të rrezatimit jo jonizues, inspektimi i subjekteve që kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues dhe sanksionet në rastin e shkeljeve të dispozitave ligjore.

Në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2014, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, janë realizuar të gjitha inspektimet e planifikuara. Gjithashtu gjatë këtij viti janë kryer inspektime dhe jashtë këtij plani.

Gjatë 2014 janë realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Për kryerjen e inspektimeve janë vënë në dispozicion nga laboratorit i ZMR-së, të gjitha pajisjet e nevojshme dhe janë realizuar matje në lidhje me fuqinë e dozës në ambientet publike, si dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është llogaritur dhe doza efektive vjetore për publikun dhe stafin.

Gjatë vitit 2014 janë realizuar 12 inspektimet në subjekte shtetërore dhe 51 inspektime në subjekte private. Pas përfundimit të inspektimit janë plotësuar proces-verbalet, ku janë përcaktuar afatet për plotësimin e procedurave për licencë dhe në rastet kur janë shkelur këto afate është plotësuar vendimi për mbyllje ose gjobë.



Numri i inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014, është rritur në krahasim me vitin 2013. Masat administrative janë marrë në zbatim të Udhëzimit Nr. 676, datë 05.12.2008 “Për shkallën e penalizimit për shkeljet administrative të parashikuara në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar. Gjatë vitit 2014 janë plotësuar 49 Proces-Verbale dhe 44 Vendime për disa subjekte private, për shkak të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit të cituar më sipër. Marrja e vendimeve nga ana e inspektorëve të ZMR për masa administrative është bërë në përputhje me ligjin dhe pasi janë vënë re shkelje nga ana e subjekteve, si dhe nuk janë zbatuar afatet e caktuara të lëna nga

inspektori në proces-verbal. Pjesa më e madhe e subjekteve ndaj të cilave është marrë masë administrative janë grafi dentare dhe panoramex.

8) Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Ministria e Punëve të Brendshme, në fushën e juridiksionit që mbulon përfshin dy inspektorate shtetërore, si më poshtë:

Inspektorati Qendror Teknik (IQT), zhvillon aktivitetin e vet sipas ligjit nr. 9595, datë 27.07.2006 “Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik” dhe ligje të tjera specifike, si dhe përfshin këto funksione inspektimi:

- a) Inspektimin e pajisjeve dhe instalimeve elektrike
- b) Inspektimi i naftës e gazit
- c) Inspektimin e pajisjeve nën presion

Inspektorati Qendror Teknik, gjatë vitit 2014, ka kryer veprimtarinë e inspektimit, sipas këtyre funksioneve, si më poshtë:

a) Inspektimin e pajisjeve dhe instalimeve elektrike

- Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike, DIPIE, për mbikëqyrjen e sigurisë elektrike, e cila përfshin kryesisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në faktorët përbërës të tij si: sigurisë së punës së impianteve, pajisjeve dhe instalimeve elektrike; përmirësim i procedurave të punës dhe të punimeve riparuese dhe rritje të shkallës së njohurive tekniko-profesionale të punonjësve që mirëmbajnë impiante, pajisje dhe instalimeve elektrike.

Në bazë të programit vjetor të punës, DIPIE ka kryer 1303 kontrole teknike sipas rëndësisë së pjesës së rrjetit që kontrollohet, nivelit të tensionit, rrezikshmërisë që paraqet, afateve të kontrollit etj. Pjesën më të rëndësishme të kontroleve teknike e zë kontrolli i tregut, i cili do të vijë duke marrë peshë gjithnjë edhe më të madhe. Nisur nga konstatimet në këto kontrole, IQT ka bërë propozime në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për ndërhyrje për përmirësimin e rregulloreve dhe kushteve teknike të projektimit për përmirësimin e skemave të instalimeve të brendshme elektrike nëpërmjet futjes në përdorim të automateve termodiferencial (salva vita). DIPIE ka vazhduar bashkëpunimin me strukturat e CEZ sh.a. dhe Albtelecom sh.a. lidhur me masat parandaluese që duhet të ndërmarrin për të rritur sigurinë elektrike të rrjeteve elektrike që ato menaxhojnë.

Në këtë periudhë, në rritje në krahasim me periudhën paraardhëse, kanë ndodhur 32 aksidente nga të cilat 26 me pasojë vdekje dhe 6 me plagosje. Nga këto 11 raste (9 me vdekje dhe 2 me plagosje) janë të elektrikistëve, ku shkak i aksidenteve është kryerja e procesit të punës pa marrë masat e domosdoshme tekniko-organizative të parrezikshmërisë. Ndërsa rastet e tjera, 21 raste (17 me vdekje dhe 4 me plagosje) janë aksidente të qytetarëve, si pasojë e ndërhyrjeve abuzive në pajisje, impiante dhe instalime elektrike, në kushtet e mosnjohjes së rrezikut elektrik që ka sjellë rënien nën tension elektrik, apo gjatë instalimit të tubacionit të pompave të ujit duke prekur linja e tensionit 10KV megjithëse ato kanë qenë në përputhje me normat teknike. Nga ana e kësaj trupe inspektuese, për trajtimin e aksidenteve, është vepruar sipas një procedure

shumëvjeçare duke përgatitur dosje të ekspertimit teknik me masat administrative përkatëse sipas përgjegjësisë (gjobë, propozim për largim nga puna ose ndjekje penale) dhe marrjen e masave parandaluese.

DIPIE, gjatë vitit 2014, ka realizuar marrjen në provim të 6818 punonjësve të personelit elektrik, me komisione të autorizuar të veçanta për KESH dhe subjekte të tjera private e publike.

b) Inspektimi i naftës e gazit

- Inspektimi i naftës e gazit që kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe të Gazit (DING) monitoron respektimin e standardeve të cilësisë së naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nga subjekte të tregtimit me shumicë e pakicë para zhdoganimit, në impiantet e prodhimit dhe instalimet e tregtimit për të shmangur abuzimet dhe falsifikimet. Në bazë të programit vjetor të punës DING ka kryer:

- 1470 inspektime të subjekteve të tregtimi me shumicë apo pakicë të karburanteve dhe lëndëve djegëse. Gjatë këtyre kontrolleve janë marrë gjithsej 6274 mostra, nga këto 1315 mostra para zhdoganimit, 4930 mostra në tregun e brendshëm dhe 29 mostra për palët e treta. Për shkelje të dispozitave ligjore në ushtrimin e aktivitetit dhe për mosrespektim të normave e kushteve teknike dhe atyre të cilësisë, janë marrë masa ndëshkimore administrative sipas përcaktimeve të ligjit. Kështu gjatë vitit 2014 kanë rezultuar 291 raste me thyerje të treguesve të standardit dhe cilësisë, si dhe 280 raste për mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor, për të cilat janë vendosur Akt-Konstatime me propozime për gjobë.

c) Inspektimin e pajisjeve nën presion

- Inspektimi i pajisjeve nën presion kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP), e cila bën evidentimin dhe inventarizimin e pajisjeve nën presion, inspektimin e subjekteve dhe pajisjeve nën presion për respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullave teknike në fuqi për futjen në treg të pajisjeve nën presion, si dhe kryerjen e inspektimit teknik periodik të detyrueshme për pajisjet nën presion nëpërmjet Trupave Inspektuese Palë e Tretë apo Organeve të Vlerësimit të Konformitetit.


Gjatë vitit 2014 janë kryer 1392 inspektime në subjekte, 2956 inspektime në pajisje nën presion, si dhe janë bërë 364 rregjistrime të pajisjeve nën presion. Pas inspektimeve të kryera janë plotësuar 1851 Akte Inspektimi, janë mbajtur 97 Akt Konstatime, si dhe janë lëshuar 119 Urdhër Ndalesa për pajisje të ndryshme nën presion.

Nga inspektimet e ushtruara në subjektet shtetërore dhe private është konstatuar se ka punonjës si kaldaist dhe përdorues të pajisjeve nën presion të cilët nuk kanë qenë të pajisur me dëshmitë përkatëse të aftësisë. Si rezultat, gjatë vitit 2014 janë lëshuar 87 dëshmi aftësie.

Objekt i aktivitetit inspektues të inspektorëve është edhe kontrolli i dokumentacionit teknik të instalimit të pajisjeve nën presion, si dhe skema apo projekti teknologjik i këtyre instalimeve. Gjatë vitit 2014 janë miratuar 34 projekte teknologjike, të cilat u përkasin subjekteve që tregtojnë me pakicë dhe shumicë Gaz të Lëngëzuar të Naftës (GLN).

Gjithashtu, gjatë vitit 2014 janë lëshuar 13 Çertifikata për automjetet që transportojnë bombola me GLN.


Inspektimet e kryera për vitin 2014




Reparti Inspektim Shpëtim Miniera (RISHM)

Reparti Inspektim Shpëtim Miniera vepron në bazë të ligjit nr. 8741 datë 15.02.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Veprimtaria e drejtorisë së inspektimit për vitin 2014, si njësi përgjegjëse në RISHM është përqendruar për realizimin e kontroleve teknike në miniera, në vlerësimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

Gjatë vitit 2014 janë kryer 526 inspektime, kundrejt 278 të kryera në vitin 2013.



Këto inspektime janë kryer në 269 subjekte minerare që punojnë dhe janë lënë Akt-kontrolle, ndërsa 122 subjekte minerare (kryesisht sipërfaqësore) janë kontrolluar dhe nuk kanë qenë duke punuar. Gjithashtu, u realizuan 104 inspektime verifikuese, 15 inspektime të posaçme të organizuara nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe 10 inspektime ekspertizë për rastet e aksidenteve, si dhe u realizuan 6 inspektime në punimet nëntokësore për ndërtimin e veprave hidroenergjetike.



Për subjektet me shkelje të disiplinës teknike janë lënë akte ndalese deri në eliminimin e të metave të konstatuara, përkatësisht: 16 raste për ndalimin e gjithë veprimtarisë dhe 18 raste për procese pune të veçanta. Për 14 subjekte minerare, është mbajtur proces-verbali i konstatimit të kundravajtjeve administrative i cili është shoqëruar me gjobën përkatëse.

Si detyrë funksionale kryesore, inspektimet për realizimin e kontrolleve teknike për sigurinë në punë në miniera, këtë vit u shoqëruan me një përmirësim cilësor të sistemit të inspektimit që në fazën e nxjerrjes së urdhrat për inspektim, programin e inspektimit, detajimin e drejtimeve të kontrollit sipas kategorisë e llojit të minierave, komunikimin dhe njoftimin e subjekteve, ndjekjen e detyrave të lëna. Gjithashtu, gjatë vitit 2014 nga specialistët e drejtorisë së Inspektimit u punua dhe u realizua drafti për projekt-ligjin e ri për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare.

9) Ministria e Mjedisit

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve dhe Ujërave, (ISHMPU), ushtron funksionin e tij në bazë të VKM nr. 46, datë 29.01.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit” (i ndryshuar), në tre funksione inspektimi, të cilat mbulohen nga drejtoritë e mëposhtme:

- a) Drejtoria e Inspektoratit të Mjedisit
- b) Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore
- c) Drejtoria e Inspektoratit të Ujërave


Drejtoria e Inspektoratit të Mjedisit, gjatë vitit 2014, programoi punën dhe ushtroi kontrolle në aktivitetet industriale lidhur me arritjen e përputhshmërisë, për zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor mjedisor dhe kushteve të lejes mjedisore.

Në lidhje me mbetjet urbane dhe mbetjet e ngurta, strukturat inspektuese të Degëve Rajonale të ISHMPU-së, gjatë muajit janar 2014, evidentuan të gjitha problematikat lidhur me menaxhimin e mbetjeve në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, si dhe vendet ku kishte nevojë për ndërhyrje. Pasi evidentuan problemet, në muajin shkurt 2014, në bashkëpunim me Forcat e Armatosura u realizua pastrimi i akseve kombëtare në të gjithë territorin nga mbetjet urbane dhe mbetjet e ngurta. Nga ky aksion u pastruan 450 km akse rrugore dhe u evaduan mbi 450 ton mbetje. Gjatë muajve prill dhe maj 2014 u ushtrua inspektim në të gjithë territorin lidhur me masat e marra nga njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e detyrave të lëna për këtë qëllim. Lidhur me shkeljet e konstatuara ndaj kryetarëve të njësive vendore janë vendosur gjithsej 139 dënime administrative me gjobë, në vlerën totale 70.000.000 lekë.

Në lidhje me aktivitetet që prodhojnë zhurma në mjedis, nga hapja e sezonit turistik veror 2014 e në vazhdim, me mbështetjen e Policisë së Shtetit janë inspektuar të gjitha aktivitetet që prodhojnë zhurma në mjedis, në veçanti në qytetin e Tiranës dhe në zonat turistike e bregdetare.

Lidhur me parandalimin e shkarkimit të ujërave të ndotura të pa trajtuara në mjedisin detar, është programuar puna dhe janë ushtruar kontrolle në zonat bregdetare.


Drejtoria e Inspektoratit të Mjedisit, gjatë vitit 2014, ka kryer gjithsej 7670 inspektime mjedisore nga të cilat janë marrë 317 masa administrative me gjobë me një vlerë totale prej 142.630.000 lekë, të cilat paraqiten edhe më poshtë:



Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore (DIPP) ka filluar punët ushtrojnë veprimtarinë inspektuese bazuar në VKM nr. 46, datë 29.01.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”. Kjo drejtori kryen funksioni për kontrollin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike. Drejton punën për parandalimin, zbulimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar dhe mjedisit natyror nga cenimi dhe ndërhyrjet e pakontrolluara, dëmtimet e paligjshme, pushtimi, shpërdorimi, tjetërsimi, shkretimi dhe degradimi i pyjeve dhe i tokës pyjore. Harton programin dhe drejton punën për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota.

Inspektorati i Policisë Pyjore është organ i specializuar i ISHMPU, me funksione teknike e kontrolluese për zbatimin e legjislacionit rregullator në fushat si: parandalimin e dëmeve në pyje e kullota dhe ndëshkimin e kundravajtësve; inspektimin e Zonave të Mbrojtura; mbrojtjen e florës e faunën e egër; inspektimin e veprimtarisë së gjuetisë; inspektimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor e kulloror dhe me produkte pyjore, drusore dhe jo drusore; inspektimin e veprimtarive të tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar; parandalimin dhe fikjen e zjarreve në pyje; mbrojtja e pyjeve nga aktivitetet e paligjshme; kontrolli i të gjitha subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit në fondin pyjor ku përfshihen shfrytëzimi i ngastrave pa rrugë auto pyjore dhe shfrytëzimi i ngastrave të veçanta. Zbatimi i projekteve teknike të shfrytëzimit, hapjes së rrugëve dhe i detyrimeve e afateve kontraktuale; kontrolli i transportit të materialit drusor me fokus sidomos në zonat e mbrojtura, zonat me pyje të lartë, zonat me të dëmtuara në vite, zonat ku prodhohen shtylla miniere, etj. duke ngritur postblloqe pyjore fikse dhe të lëvizshme; kontrolli i zënieve e përdorimit të paligjshëm të fondit pyjor e kulloror; kontrolli i masave për parandalimin dhe fikjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe zbatimi i Moratoriumit të gjuetisë.

Gjatë vitit 2014 janë kryer gjithsej 2850 inspektime në terren nga të cilat janë proceduar 514 kundravajtës. Nga këto 485 janë procedime administrative ku janë vendosur 35.000.000 lekë gjobë dhe 29 janë dërguar për ndjekje penalisht, të cilat paraqiten edhe më poshtë:



Janë ushtruar inspektime në Degët Rajonale të ISHMPU-ve: Vlorë, Korçë, Fier, Lezhë, Shkodër, Dibër, Durrës, Tiranë, Berat, Kukës etj. hartuarave anë të të cilave është bërë vlerësimi i situatës dhe janë bërë rekomandimet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve.

Janë inspektuar të gjithë subjektet e shfrytëzimit të materialit drusor që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor dhe janë marrë masa sipas rezultateve të inspektimit. Është bërë inspektimi i subjekteve që grumbullojnë e tregtojnë material drusor dhe sipas rastit janë marrë masa administrative të sekuestrimit të materialit drusor dhe vendosur gjobat përkatëse. Është sekuestruar në mbi 319 raste, volumi prej 2370 m³ lëndë drusore, nga këto lëndë punimi 760 m³, dru zjarri 1610 m³. 70 % e kundravajteve janë kryer në pyje në pronësi shtetërore, 29 % komunale dhe 1 % private.


Gjithashtu janë kryer inspektime në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit, në 90 furra e gropa për prodhimin e gëlqeres në rrethin e Krujës të cilat janë prishur; në Qarqet e Korçë, Gjirokastrë, Shkodër, Berat, Dibër, janë inspektuar 30 HEC në bashkëpunim me drejtorinë e inspektimit të mjedisit për respektimin e kërkesave ligjore dhe zënie të fondit pyjor dhe janë lënë afate për plotësimin e dokumentacioneve të nevojshme dhe janë marrë vendime ndëshkimore sipas rastit; janë kryer inspektime të aktivitetit në fondin pyjor të subjekteve minerare në rrethin Bulqizë, qarku Dibër dhe janë marrë masat përkatëse; janë kryer 9 procedime në fondin kullosor me vlerë 560 mijë lekë dhe janë vendosur 280 mijë/lekë gjobë për dëmtime në fondin kullosor.

Në lidhje me aktivitetin e gjuetisë, janë ushtruar 350 inspektime në zonat e gjuetisë në Durrës, Kurbin, Shkodër, Fier, Vlorë, etj., në të cilat u proceduan për gjueti të paligjshme 30 persona, u vendosën 1.57 milion lekë gjoba, u sekuestruan në bashkëpunim me Policinë e Shtetit rreth 630 armë gjahu, si dhe u sekuestruan mjete e pajisje të ndaluara për gjueti.


Për verifikimin e ankesave sipas letrave të ardhura nga Korçë, Malësi Madhe, Dibër, Mat, Bulqizë, Librazhd, Tiranë, Përmet, Gjirokastrë, Has, Kukës, Lezhë, Durrës, Vlorë, Berat, Skrapar etj. janë kryer inspektime dhe u dhanë rekomandime e u morën masat përkatëse.

Duke analizuar sezonin e zjarreve janë konstatuar 50 raste zjarresh përkatësisht: në pyje 15 raste, që kanë djegur sipërfaqen prej 18 ha në pyje, nga të cilat 2 ha në trungishte halore pyje shtetërore, 16 ha në pyje komunale, si dhe në kullota 35 raste, që kanë djegur 33 ha në pronësi të komunave.

Drejtoria e Inspektoratit të Ujërave gjatë vitit 2014 ka kryer gjithsej 2795 inspektime nga të cilat janë vendosur 89 gjoba me një vlerë totale prej 70.700.000 lekë, si dhe ka patur 87 raste të pezullimit dhe mbylljes së aktivitetit.



Masat administrative me gjobë, sipas tipit të aktiviteteve dhe prioriteteve për vitin 2014, janë vendosur përkatësisht në: shfrytëzim inertesh lumore, 49 gjoba, me vlerë 47.400.000 lekë; shkarkimet në ujëra, 12 gjoba, me vlerë 19.000.000 lekë; si dhe përdorim burimi ujq, 28 gjoba, me vlerë 4.300.000 lekë, të cilat paraqiten edhe më poshtë:




10) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) u krijua me Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, sipas VKM Nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” dhe me fonde të BE-së, Qeverisë Shqiptare, mbështetjen e ekspertëve të huaj. Struktura e këtij institucioni është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 119, datë 10.03.2014, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”. Aktualisht, funksionon si një institucion i konsoliduar me 12 Drejtori Rajonale dhe ka për mision: Të vendosë dhe të konsolidojë në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar, prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore, në sigurimin e prodhimit bujqësor, për parandalimin e impakteve negative të përdorimit të pesticideve, të farërave dhe plehrave të përdorimit për bimësinë.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit përbëhet nga dy drejtori, Drejtoria e menaxhimit të riskut dhe koordinimit të inspektimit dhe Drejtoria e vlerësimit dhe komunikimit të riskut.

Drejtorja e menaxhimit të riskut dhe koordinimit të inspektimit është përgjegjëse për koordinimin e gjithë procesit të inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore të opertorëve të biznesit ushqimor, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe mbështetjen e Laboratorëve. Gjatë vitit 2014 ka kryer **35100 inspektime**, sipas fushave përkatëse.



Kjo Drejtori ka qenë pjesë aktive në unifikimin e procedurave për kryerjen e inspektimeve, hartimin dhe unifikimin e dokumentacionit të inspektimeve që do të hidhet në portalin “e-Inspektimi”, si dhe përmirësimin e bazës ligjore sipas sektorëve përkatës e riorganizimin më të mirë dhe më eficient të aktiviteteve që mbulon.

Gjithashtu ka marrë pjesë në hartimin për herë të parë të Planit të Kontrollit Zyrtar Vjetor me bazë risku dhe Planin e Marrjes së Mostrave, për vitin 2015. Plani vjetor me bazë risku do të bëjë

të mundur që kontrollet zyrtare të kryhen sipas standardeve Evropiane, sipas një metodologjie për përcaktimin e prioriteteve të kontrollit me bazë risku, duke përcaktuar frekuencën e përshtatshme të kontrolleve zyrtare në lidhje me nivelin e riskut, burimet e disponueshme dhe përcaktimin e objektit të kontrollit. Kjo drejtori ka kryen veprimtarinë sipas tre sektorëve në vijim:

- *Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Joshtazore dhe Operatorëve të Biznesit*, koordinon të gjithë procesin e inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë joshtazore dhe operatorëve të biznesit.

Në objektivat e vitit 2014, për këtë sektor, ishin rritja e kërkesave për gjurmueshmërinë, si dhe implementimi i procedurave të vetëkontrollit sipas parimeve të HACCP⁹ për rritjen e cilësisë së inspektimeve; unifikimi i listë-verifikimeve për këtë fushë inspektimi, procedurave të inspektimit dhe dokumentacionit të miratuar; hartimi i Planit vjetor për kontrollet zyrtare me bazë risku dhe marrjen e mostrave; intensifikimin e inspektimeve për monitorimin e vazhdueshëm për cilësinë dhe sigurinë e prodhimit, ambalazhimit dhe tregimit të miellit dhe nënprodukteve të tij, nivelin e jodit në kripë në të gjitha hallkat, ushqimeve të shpejta që lidhet me sigurinë ushqimore të vajit të përdorur për skuqje; OBU importues, tregtues, prodhues dhe përdorues të ujit mineral natyral dhe ujit mineral natyral me gaz karbonik të shtuar, fillimin e implementimit të procedurave të sistemit të vetëkontrollit (HACCP); OBU¹⁰ të regjistruar apo të paregjistruar, sipas qarqeve dhe bashkëpunimi me organizmat shtetëror përgjegjës për regjistrimin e tyre; forcimi i kërkesave për zbatimin e ligjit mbi etiketimin në shqip të produkteve ushqimore të importit, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe trajnimit të inspektorëve mbi zbatimin e kërkesave ligjore.


Puna e kryer gjatë vitit 2014 ka qenë koordinimi, mbështetja dhe inspektime të përbashkëta në Sektorë në Operatorët e Biznesit në Drejtoritë Rajonale të AKU-së. Për periudhën janar-dhjetor 2014 janë kryer gjithsej **17264 inspektime** tek OBU që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë ushqime me origjinë joshtazore. Janë vendosur masa administrative si: 2405 paralajmërime, 110 gjobë me një vlerë prej 2899000 lekë, 94 subjekte me pezullim aktiviteti, si dhe janë bllokuar dhe asgjësuar 851,2164 tonë mallra me vlerë 26037167 lekë.

Ka pasur problematika të konstatuara gjatë kontrolleve zyrtare, të cilat kanë qenë të lidhura kryesisht me sistemin, procedurën dhe dokumentet e inspektimit, si: mospërputhje të planeve të punës me realizimet e tyre sipas parashikimeve, mungesë e hedhjes së praktikave të inspektimi në sistemin e *Aku-net*¹¹ në mënyrë periodike, mungesë e listë verifikimit në praktikat e inspektimit, lënie detyrash por jo afate kohore për zbatimin e tyre nga OBU, mosplotësim të kërkesave ligjore për evidentimin profesional të të dhënave të procesverbaleve të inspektimit dhe listë verifikimet përkatëse në të gjitha rubrikat e tyre sipas objektit të kontrollit, sistemin e vetëkontrollit (HACCP), regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave për efekt gjurmueshmërie, hartimin dhe kontrollin e luftës kundër brejtësve dhe dëmtuesve të tjerë. Gjatë vitit 2014, në të gjithë vendin, ishin 136 OBU të cilat implementuan sistemin e HACCP dhe vihet re një rritje e OBU-ve të cilat kanë implementuar dhe janë në proces implementimi të sistemit HACCP.

⁹ Hazard analysis and critical control points.

¹⁰ Operatorët e Biznesit Ushqimor.

¹¹ Sistemi i përdorur nga AKU deri tani.



Të gjitha këto probleme pritet të shmangen me futjen në procedurën e re të inspektimit nëpërmjet portalit “e-inspektimi”, i cili është planifikuar të jetë aktiv gjatë vitit 2015.

Objektivat për vitin 2015 në kuadër të garantimit të sigurisë ushqimore do të synojnë plotësimin e kërkesave për gjurmueshmërinë dhe implementimin e procedurave të vetëkontrollit sipas parimeve të HACCP; rritjen e cilësisë së inspektimeve e përmirësimin e performancës së inspektorëve nëpërmjet trajnimit të tyre me bazën ligjore, si dhe me urdhrat dhe udhëzimet e reja; rritjen e frekuencës së inspektimeve.

- *Spektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit* koordinon të gjithë procesit të inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe operatorëve të biznesit.

Objektivat për vitin 2014 kanë qenë monitorim i vazhdueshëm për zbatimet e rekomandimeve të FVO për stabilimentet e përpunimit dhe tregtimit të peshkut, monitorimin e vazhdueshëm në stabilementet prodhuese dhe përpunuese të qumështit e ato përpunuese të mishit, ato tregtuese të daterit dhe llojeve të peshkut të cilat janë të ndaluar në ligjin e peshkimit, kontrolleve në OBU për fillimin e implementimit të procedurave të sistemit të vetëkontrollit (HACCP).

Puna e kryer gjatë vitit 2014. Spektori ka punuar në drejtimet e Plan Veprimit “Për evidentimin e operatorëve ushqimor në Rang Kombëtar, të cilët prodhojnë dhe tregtojnë djath me niseshte, urdhër “Për kontrollin, evidentimin dhe marrjen e masave për ndalimin e hedhjes në treg ose për konsum të organizmit ujor” “Gurëshpuesi”, DATERI e urdhër “Për monitorimin e njësive të tregtimit të mishit dhe thertoreve dhe njësive të therjes dhe subjekteve të ndryshme të cilat tregtojnë produkte me origjinë shtazore”, procesin e threjes së kafshëve”, inspektimin e operatorëve të biznesit ushqimor të cilët prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë produkte ushqimore (bar, restorant, fast-food, pastiçeri, supermarkete, minimarkete), inspektimin e stabilementeve të peshkut dhe produkteve të tij me të drejtë eksporti në BE, subjekteve të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë produktin ushqimor “Mjaltë”, si dhe për festa inspektimin e restoranteve, njësive të tregtimit të mishit, supermarketeve, tregje, etj.

Për vitin 2014 janë kryer gjithsej **12446 inspektime**, tek OBU që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë ushqime me origjinë shtazore. Janë vendosur masa administrative si: 1250 paralajmërime, 167 gjobë me një vlerë prej 12841000 lekë, 320 subjekte me pezullim aktiviteti, si dhe janë bllokuar dhe asgjësuar 1625,02 tonë mallra.

Objektivat për vitin 2015 janë për monitorim i vazhdueshëm për zbatimet e rekomandimeve të FVO për stabilimentet e përpunimit dhe tregtimit të peshkut, monitorim i vazhdueshëm për

zbatimet e rekomandimeve të FVO për stabilimentet e grumbullimit e paketimit të vezëve të klasit “B”, monitorimin e vazhdueshëm në stabilementet prodhuese dhe përpunuese të qumështit, si dhe në pikat grumbulluese të qumështit, përpunuese të mishit, të daterit dhe llojeve të peshkut të cilat janë të ndaluar në ligjin e peshkimit.

- *Spektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore*, për vitin 2014 ka patur si qëllim zbatimin me korrektësi të legjislacionit në fuqi, për të rritur sigurinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor, me qëllim ruajtjen e shëndetit të konsumatorit.

Gjatë vitit 2014 ka një trend rritje të numrit të inspektimeve përkatësisht nga 3449 inspektime të kryera në vitin 2013 në **5393 inspektime** për vitin 2014.

Janë vendosur masa administrative si: 181 paralajmërime, 76 gjobë me një vlerë prej 2950000 lekë, 33 subjekte me pezullim aktiviteti, 205 bllokime të inputeve bujqësore, pra janë penalizuar rreth 9 % të subjekteve të inspektuara.

Problematikat kryesore të konstatuara në tregtimin e PMB-ve me shumicë apo me pakicë, plehrave të përdorimit për bimësinë, prodhimin dhe tregtimin e MMSHB-ve janë në dokumentacion në regjistrin e shitjeve dhe blerjeve, të recetave për tregtimin e të PMB-ve, dëshmitë e aftësisë për përdorimin e PMB-ve “të rrezikshme” dhe me “rrezik të lartë”, çertifikata e regjistrimit, çertifikata e origjinës dhe ajo e analizës, etiketa e prodhuesit dhe tregtuesit jo të rregullta.

Si rezultat i përmirësimit të kuadrit ligjor, unifikimit të procedurave për kryerjen e inspektimeve dhe intensifikimit të tyre, këshillimit të vazhdueshëm të subjekteve, si dhe zbatimit të masave administrative, u arrit përmirësim i dukshëm i kushteve të ruajtjes së inputeve bujqësore në pikat e tregtimit, sistemimin dhe mirëmbajtjen e evidencave dhe dokumentacionit, tregtimin dhe plotësimin gradualisht me receta të PMB-ve “me rrezik dhe rrezik të lartë”.

Objektivat 2015 janë hartimi i një programi sa më real të inspektimeve me bazë risku bazuar në problematikat e hasura dhe specifikën që ka çdo qark gjatë gjithë vitit bujqësor, zbatimin me korrektësi në të gjitha Pikat e kalimit kufitar të legjislacionit në fuqi, eliminimin e pengesave artificiale për operatorët e biznesit ushqimor.

- *Spektori i koordinimit të Inspektorëve në Pikat e kalimit kufitar*, siguron zbatimin me përpikmëri të legjislacionit në të gjitha Pikat e kalimit kufitar. Në të gjitha Pikat e kalimit kufitar, në vitin 2014, janë kryer **43863 inspektime** gjithsej, të ndara në 28602 inspektime për produkte ushqimore dhe 15261 për imputet bujqësore.

- *Spektori i koordinimit dhe mbështetjes së laboratorëve* konsiston në veprimtarinë e koordinimit, mbështetjen dhe inspektimin e Sektorëve të Shërbimeve Laboratorike të AKU-së, në të cilët kryhet analizimi laboratorik për kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe bimëve.

Gjatë vitit 2014 u analizuan në total 15858 mostra për 38276 tregues përkatësisht analitikë fiziko-kimikë, mikrobiologjikë, të shëndetit të kafshëve dhe të mbrojtjes së bimëve. Bazuar në të dhënat mbi origjinën e mostrave në 45% të rasteve ka qenë nga kontrollet zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar, në 21% të rasteve nga kontrollet zyrtare në terren dhe në 34% të rasteve kanë qenë analiza vetëkontrolli. *Për monitorimin e qumështit, vlerësimin mikrobiologjik të qumështit të papërpunuar gjatë 2014* janë realizuar inspektime me objekt monitorimi fermat prodhuese, pikat e grumbullimit, fabrikat e automatizuara, fabrikat gjysëm të automatizuara dhe baxhot (≥ 10 kv).

Gjatë periudhës 14.05 - 28.05.2014 sipas një plani për monitorimin e OBU është bërë monitorimi i miellit integral që prodhojnë dhe tregtojnë produktin ushqimor Bukë e Zezë apo Bukë Integrale për vlerësimin e miellit integral, janë analizuar gjithsej 287 mostra mielli për treguesit e hirit e glutenit.

V. KOMENTE

Nga Raporti i vitit 2014, del qartë se inspektoratet shtetërore, gjatë këtij viti, filluan të zbatojnë parimet e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektoratet shtetërore kanë përshtatur procedurën e inspektimit dhe dokumentet e inspektimit që ato përdorin me procedurën dhe dokumente unike të inspektimit të miratuar nga Inspektorati Qendror.

Në përgjithësi inspektoratet shtetërore ende nuk kryejnë programimin e veprimtarisë së tyre inspektuese, vjetor e mujor, në bazë të metodologjisë së vlerësimit të riskut. Në lidhje me procedurat, dokumentet e inspektimit, si dhe programin mbi bazë risku, në tre inspektoratet shtetërore që janë mbikëqyrur nga Inspektorati Qendror, u vërejtën mangësi për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse. Plotësimi i këtyre rekomandimeve do të jenë objekt i mbikëqyrjes nga Inspektorati Qendror edhe në të ardhmen, në mënyrë që të avancohet në lidhje me këto veprimtari të inspektorateve shtetërore.

Gjithashtu, objekt i mbikëqyrjes së Inspektoratit Qendror kanë qenë edhe procesi i ankimit për masat administrative të marra nga inspektoratet shtetërore dhe apelimit të këtyre masave administrative, si dhënënyra e mbledhjes së gjobave. Jo të gjithë Inspektoratet shtetërore kanë dhënë informacione të qarta në lidhje me buxhetet e tyre, për të cilat është kërkuar që të jenë pjesë e raportimeve vjetore. Për më tepër vërehet se, megjithëse është dërguar një model unik raportimi, raportet e inspektorateve shtetërore nuk paraqiten sipas këtij formati.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së inspektorateve, është venë re ka edhe mbivendosje të ligjeve sektoriale. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor vë në dukje këtë mbivendosje të ligjeve sektoriale, që krijojnë problematikë dhe ngarkesë për subjektet, si rrjedhojë e inspektimit të dyfishtë. Ligjet sektorale që kanë mbivendosje janë ligji nr. 8025, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rezatimet jonizuese” (i ndryshuar) dhe ligji nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për rezatimet jojonizuese” (i ndryshuar) dhe përlpasja në këtë rast ndodh me Zyrën e Mbrojtjes nga Rezatimet, të cilët kanë në funksion si liçensimin, ashtu edhe inspektimin e subjekteve, ndërkohë që pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ka inspektorë të kualifikuar në fushën e rezatimit që mund të merren me procesin e inspektimit të kësaj fushe.

Konstatohet se, gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të inspektorëve shtetërorë, të cilët janë trajnuar për zbatimin e parimeve të ligjit të ri të inspektimit, si dhe me procedurat e dokumentet e reja të inspektimit. Trajnimi i kryer, nuk është shoqëruar me pajisjen e tyre me certifikatë për shkak të një ngërçi ligjor. Gjithashtu, Inspektorati Qendror vazhdon procesin e pajisjes së inspektorëve shtetëror me kartë inspektori.

VI. PRAKTIKAT E MIRA

Gjatë shqyrtimit të raporteve vjetore të paraqitura nga Inspektoratet shtetërore, dhe nga analiza e veprimtarisë së Inspektoratit Qendror, në praktikat e mira mund të përmendet bashkëpunimin e mirë ndërmjet inspektorateve shtetërore të cilat ishin ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Bashkërendimi i inspektimeve të përbashkëta ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe jo vetëm, mundësoi zbatimin me efektivitet i këtij ligji nga këto inspektorate shtetërore.

VII. MENAXHIMI FINANCIAR I INSPEKTORATIT QENDROR

Në kuadër të përmbushjes së gjithë aktivitetit të Inspektoratit Qendror, buxheti i institucionit është shpenzuar për kryerjen e detyrave funksionale të këtij institucioni. Plani i buxhetit të vitit 2014, i miratuar nga Ministria e Financave, për Inspektoratin Qendror, ka qenë 82,436,000 lekë në total dhe i detajuar sipas zërave më poshtë:

000 / lekë

BUXHETI I VITIT 2014					
Nr.	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Plani 2014	Fakti 2014	Diferenca Plan/Fakt	Realizimi i buxheti në %
1	Paga, shpenzime të tjera personeli	19,140	15,822	3,318	82.6%
2	Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore	3,880	2,350	1,530	60.5%
3	Mallra, shërbime dhe shpenzime të tjera operative	16,600	3,181	13,419	19.1%
4	Investime	42,816	41,568	1,248	97%
	T O T A L I	82,436	62,921	19,515	76.3%

Buxheti vjetor u realizua sipas akteve ligjore ekonomiko-financiare në fuqi për të gjitha zërat e tij.

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore e zë vlera e investimeve, e cila ka një peshë specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve buxhetore, ndërsa fondi i pagave me kontributin e sigurimeve në vlerë absolute është më i vogël.

Zëri i buxhetit 231 “Investime”, i cili ishte me një vlerë totale prej 42,816,000 lekë, u realizua në masën 97 %, duke mbështetur aktivitetin normal të institucionit në fuqizimin e Portalit unik të inspektimit “e-inspektimi”. Gjithashtu, për të gjitha procedurat e prokurimit është zbatuar Ligji i Prokurimit Publik.

I gjithë buxheti i miratuar për vitin 2014 u realizua në masën 76.3 % të fondit të miratuar për t’u shpenzuar për këtë periudhë. Shifra e mosrealizimit në vlerë absolute prej 19,515 lekësh, në pamje të parë është një shifër e madhe e cila të bën të mendosh se është një rezervë e madhe e pa

përdorur. Në fakt mosrealizimin në buxhet e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, pasi në këtë zë kemi patur mungesë personeli me 2 specialistë nga 15 që ka e gjithë organika e Inspektoratit Qendror. Këto vende vakante u plotësuan sipas procedurave të shërbimit civil në fund të vitit 2014.

Mosrealizimi në shpenzime operative, ka ardhur si rezultat i planifikimit më të lartë se sa nevojat.

Inspektorati Qendror, për vitin 2015 ka hartuar një buxhet më realist, i cili do të lejojë të kryejë në kohë të gjitha aktivitetet e planifikuara, për përmbushjen e misionit të tij.

VIII. REKOMANDIME

Mbi bazën e analizës së kryer mbi aktivitetin e Inspektorateve Shtetërore për vitin 2014 dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre gjatë kësaj periudhe, rekomandohet si më poshtë:

- Të përfundojë riorganizimi i inspektorateve shtetërore dhe të hartohen deklarata të qarta që përshkruajnë misionin e secilës prej tyre, i cili duhet të fokusohet në objektivat për mbrojtjen e interesit publik sipas fushave që ato mbulojnë, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së konsumatorëve.
- Pas miratimit nga Inspektorati Qendror të metodologjisë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së punës së inspektorateve shtetërore, këto të fundit të zhvillojnë treguesit e tyre të performancës, në bashkëpunim me komunitetin shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit dhe bazuar në praktikën më të mira kombëtare e ndërkombëtare. Vlerësimi i punës së tyre në vazhdim do të bëhet sipas këtyre treguesve.
- Të përfundojë unifikimi i procedurës dhe dokumenteve të inspektimit, për ato inspektorate që janë në process. Të zbatohen rregullat e programimit të veprimtarisë inspektuese sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut të miratuar nga Inspektorati Qendror, pasi të jenë përshtatur për funksionet e inspektimit që mbulojnë.
- Legjislacioni themelor dhe rregulloret e çdo inspektorati shtetëror duhet të jenë koherente dhe të evidentojnë ndryshimet e bëra çdo vit në këtë drejtim. Përafrimi i legjislacionit të fushave të ndryshme të inspektimit me *acqui communautaire* për fuqizimin e mbrojtjes së interesit publik nëpërmjet veprimtarisë së këtyre inspektorateve.
- Organizimi i inspektimeve të përbashkëta nga ana e inspektorateve shtetërore, nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, për të zvogëluar barrën ndaj subleve të inspektimit. Të zgjerohet fokusi i ndërveprimit midis inspektorateve shtetërore e të përfshijë inspektime të përbashkëta me qëllim parandalimin e moszbatimit të kërkesave ligjore.
- Inspektoratet shtetërore duhet të hartojnë statistika të sakta dhe përmbledhëse, për të mundësuar analiza të qëndrueshme për të bërë përmirësimet e duhura. Të publikojnë të dhënat e veprimtarisë së tyre për të rritur transparencën ndaj publikut.
- Të ushtrohet mbikëqyrje efektive mbi aktivitetin e inspektimeve për të rritur përgjegjshmërinë në punë të inspektorëve.
- Inspektoratet shtetërore të kenë Linjë telefonike falas për bizneset dhe qytetarët në lidhje me ankesat, për të përmirësuar veprimtarinë e tyre në lidhje me minimizimin e veprimeve korruptive në fushat e inspektimit që ato mbulojnë.
- Ëëbsite të përditësuara të Inspektorateve shtetërore, të publikojnë broshurë për subjektet me procedurat e inspektimit dhe informacione të tjera të vlefshme për një partneritete më të mirë me subjektet. Informimi i subjekteve dhe publikut duhet të përmirësohet më tej në mënyrë që subjektet e inspektimit që operojnë në Shqipëri dhe publiku të njohin të drejtat dhe detyrat e tyre.
- Të bëhet promovimi i procedurave të reja nëpërmjet portalit unik “e-inspektimi” tek subjektet e inspektimit dhe publiku i gjerë. Të bëhet promovimi i Inspektoratit Qendror me postera dhe fletëpalosje rreth aktivitetit të këtij institucioni përgjegjës për rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

IX. KONKLUZIONE

Finalizimi i reformës do të arrihet nëpërmjet përmbushjes së të gjitha objektivave të analizuara më sipër. Për këtë nevojitet bashkëpunim i Inspektoratit Qendror me inspektoratet shtetërore dhe këto të fundit ndërmjet tyre. Për këtë arsye duhet të organizohen takime midis drejtuesve të këtyre institucioneve në çdo 6 muaj për të bashkërenduar aktivitetin e institucioneve të tyre, me koordinimin e Inspektoratit Qendror.

Të gjitha përpjekjet e bëra për zbatimin e ligjit të inspektimit, kanë çuar në unifikimin e procedurës së inspektimit për pjesën më të madhe të inspektorateve shtetërore për sa i takon programimit, vlerësimin të riskut, dokumentimin të veprimtarisë inspektuese, si dhe vlerësimin mbi bazë performance. Kapacitetet njerëzore mbeten ende të dobëta, kjo është një nga arsyet e mosfunksionimit të hallkave të veçanta të ligjit të inspektimit, prandaj është e domosdoshme hartimi dhe zbatimi i procedurave të trajnimit dhe certifikimit të inspektorëve.

Nisur nga rastet e identifikuara gjatë veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, është e rëndësishme të përfundojë pajisja e inspektorëve shtetërorë me kartë inspektori, e cila është e detyrueshme të përdoret prej tyre gjatë inspektimeve. Pajisja e tyre me kartë inspektori shtetëror do të evitojë inspektimet e paligjshme të personave jashtë inspektorateve shtetërore. Përditësimi i emrave të inspektorëve në detyrë, të cilët kanë të drejtë të kryejnë procedurë inspektimi dhe konsolidimi i tyre në Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve do të mbështesë këtë proces.

Duke parë ecurinë e implementimit të Portalit unik “e-inspektimi”, duhet të merren masa për të vënë në funksionim procedurat e inspektimit elektronik katër inspektoratet që tashmë kanë bërë gati dokumentacionin dhe janë pajisur me paketa inspektimi.

Inspektorati Qendror duhet të rrisë rolin e vet koordinues dhe mbikëqyrës të veprimtarive të inspektimit, për të rritur sigurinë e zbatimit të ligjit të inspektimit dhe ligjeve sektorale nga ana e inspektorateve shtetërore.

X. ANEKSE**ANEKSI I: Akte nënligjore të miratuara gjatë vitit 2014 nga Inspektorati Qendror.**

Nr.	Baza ligjore (ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e miratimit
1.	neni 16, pika 2, germa ç	Urdhër nr. 28, datë 17.04.2014 “Për miratimin e kodit të etikës për punonjësit e ISH”	17.04.2014
2.	neni 30, pika 4	Urdhër nr. 32, datë 29.04.2014 “Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit”	29.04.2014
3.	neni 16, pika 2, germa c; neni 28, pika 4	Urdhër nr. 58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e dokumenteve standarte të inspektimit”, i ndryshuar	21.08.2014
4.	VKM nr. 696, datë 16.08.2013; ligji nr. 76/2014	Udhëzim nr. 65, datë 19.09.2014 “Për bashkërendimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga duhani”	19.09.2014
5.	neni 16	Urdhër nr. 74, datë 30.12.2014 “Për miratimin e manualit të mbikqyrjes së veprimtarisë pranë ISH/ vendore dhe trupa të tjera inspektuese”	30.12.2014

ANEKSI II: Ligje sektorale të miratuara gjatë vitit 2014.

Nr.	Emërtimi i aktit ligjor	Data e miratimit
1.	Ligji Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (AKBPM)	01.08.2014
2.	Ligjin Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” (AKBPM)	15.08.2014
3.	Ligji Nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar (IKMT)	16.01.2015

ANEKSI III: Draft akte nënligjore për miratim

Nr.	Baza ligjore (ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”)	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e pritshme e miratimit
1.	shkronja c), pika 2, neni 16	Rregulla të përgjithshme bazë për metodologjinë e vlerësimit të riskut	Hartuar në vitin 2014 dhe miratuar në vitin 2015
2.	shkronja c), pika 2, neni 16	Programimi i inspektimeve	Hartuar në vitin 2014 dhe miratuar në vitin 2015
3.	shkronja c), pika 2, neni 16	Dokumentimi i inspektimeve	Hartuar në vitin 2014 dhe miratuar në vitin 2015
4.	shkronja c), pika 2, neni 16	Raportimi i veprimtarisë së inspektorateve	Hartuar në vitin 2014 dhe miratuar në vitin 2015
5.	shkronja ç), pika 2, neni 16	Rregulla të Përgjithshme bazë mbi Treguesit e Efektivitetit dhe Cilësisë së Veprimtarisë së Inspektimit dhe Kriteret e Vlerësimit e Raportimit të tyre	Hartuar në vitin 2014 dhe miratuar në vitin 2015
6.	pika 3, neni 21	VKM për intervalet e testimit periodik rregullat e hollësishme për procedure e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë	Brenda vitit
7.	pika 7, neni 48	VKM për rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit	Brenda vitit
8.	pika 3, neni 51	VKM për Organizimi i organit epror për çdo inspektorat shtetëror	Brenda vitit
9.	pika 2, neni 26	VKM për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore, në varësi të madhësisë së	Brenda vitit

RAPORTI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2014

		subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë	
10.	pika 7, neni 38	VKM për procedurat për marrjen dhe trajtimin e mostrave sipas tipit të inspektimit si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve	Brenda vitit
11.	neni 16	VKM Rregullore për përdorimin e portalit “e- Inspektimi”	Brenda vitit